



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 43 regjistër (JR)
Datë 05.11.2024

Nr. 61 i vendimit
Datë 23.07.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 23.07.2025, ditën e mërkurë, në orën 15:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Inva Hasho, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 43/2024 (JR), datë 05.11.2024, që i përket:

ANKUES: Komisionerja Publike, Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 802, datë 23.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi pretendimet e Komisioneres Publike të paraqitura në ankim, parashtrimet dhe bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme (pas kalimit procedural), i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 802, datë 23.9.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), shqyrtoi parashtrimet dhe bisedimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, e cila përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Komisioni, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar), (në vijim “AKSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: *a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; d) nuk ka kryer deklarim të rremë; e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 AKSIK-ja, pasi kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit raportin² mbi kontrollin e figurës, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin ka arritur në konkluzionin: *“Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Flora Çela, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit”.*

2.3 KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë (5) dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar pranë Komisionit një raport³ të hollësishëm, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 802, datë 23.09.2024, ka vendosur: *“Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”.* Ky vendim është marrë bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe në konkluzionet për secilin prej kritereve të rivlerësimit, si më poshtë.

¹Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklarates së pasurisë së subjektit Flora Çela, është përcjellë në Komision nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 29.03.2018.

² Raporti nr. {***} prot., datë 13.07.2023, i deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZh-së nr.{***}, datë 14.07.2023.

³Raport për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela nr. {***} prot., datë 23.05.2023.

i. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë: *Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.*

ii. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës: *Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.*

iii. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Trupi gjykues i Komisionit, pasi: (i) administroi vlerësimin e ardhur nga Shkolla e Magjistraturës, e cila ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e ndërmjetëm të Komisionit; (ii) shqyrtoi në tërësi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë – arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit

4. Komisionerja Publike, në zbatim të Rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), të datës 16.10.2024, ka paraqitur ankim⁴ kundër vendimit nr. 802, datë 23.09.2024, të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji, që, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë: *Ndryshimin e vendimit nr. 802, datë 23.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela.*
5. Komisionerja Publike ka çmuar se rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ, lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, janë të tilla që nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të edukimit të Shkollës së Magjistraturës, dhe se subjekti i rivlerësimit ka një model pune, që nuk pajtohet me pozicionin e saj dhe nuk arrin të përmbushë kriteret kushtetuese për arritjen e një niveli kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës. Këto rrethana të konstatuara nga vetë Komisioni në disa çështje penale⁵, së bashku me gjetjet e saj në dy procedimet penale me nr. {***/2017 dhe nr. {***/2017, në vlerësimin e Komisioneres Publike do të përbënin mjaftueshëm një bazë të dhënash mbi të cilën, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, mund të konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka shkelur besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që bëjnë të mundur aplikimin e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
6. Në ankimin e Komisioneres Publike evidentohen dhe parashtrohen në mënyrë të përmbledhur konstatimet dhe gjetjet si më poshtë.

6.1 Lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 13.07.2017 dhe procedimet e lidhura me të, *subjekti i rivlerësimit, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar*

⁴ Ankimi është regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 28.10.2024.

⁵ Procedimet penale nr. {***/2017 dhe nr. {***/2017, si dhe çështjet penale të adresuara nga denoncuesit M. Ç., V. H., R. B. dhe M. M..

ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. Nga ana e subjektit të rivlerësimit është kryer një hetim i paplotë, si dhe nuk janë mbledhur të gjitha provat e kërkuara, për qartësimin e rrethanave të rastit në përputhje me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

6.2 Gjatë seancës dëgjimore në Komision, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta dhe është përpjekur t'i shmanget përgjigjes së pyetjes së vëzhguesit ndërkombëtar lidhur me njohjen me shtetasin M. B., për të cilin Komisioni ka administruar akte nga Prokuroria Vlorë, si rezultat i informacioneve të marra nga AKSIK-ja.

6.3 Lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 18.09.2017, subjekti i rivlerësimit: a) nuk ka kryer hetime shteruese, si dhe nuk ka konsideruar “sigurimin e padisë” apo çdo të dhënë tjetër të dalë gjatë hetimit dhe, për pasojë, nuk është vlerësuar drejt fakti penal⁶; b) vendimi për kryerjen e aktit të ekspertimit si detyrë e lënë nga gjykata është marrë në kohë relativisht të gjatë nga vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, datë 13.10.2020; c) nuk pasqyrohen në dosje veprime hetimore të kryera deri në caktimin e kryerjes së aktit të ekspertimit.

6.4 Lidhur me çështjen penale të adresuar nga denoncuesja M. Ç., vendimi i mosfillimit (edhe në konsideratë të shpjegimeve të subjektit për ekzistencën e muajit gusht si kohë e kryerjes së pushimeve vjetore) është marrë në tejkalim të afatit 15-ditor, sikurse parashikohet në nenin 291/1 të Kodit të Procedurës Penale.

6.5 Lidhur me çështjen penale të adresuar nga denoncuesi V. H., subjekti: a) është vënë në lëvizje në intervale të gjata kohore për marrjen e akteve, duke proceduar në tejkalim të afateve kohore të arsyeshme; b) ka marrë vendim thuajse pas 3 muajve nga nisja e rihetimit datë 04.03.2021, më datë 31.05.2021 (njoftuar denoncuesit më 10.06.2021), për bërjen e aktit të ekspertimit, duke mos ndërmarrë në kohë veprimin e lënë nga gjykata. Subjekti i rivlerësimit, dhe në këtë rast ka shfaqur mangësi në drejtim të administrimit të akteve dhe mbikëqyrjen e tyre, ka ceduar në efektivitetin e zbatimit të procedurave brenda afateve kohore.

6.6 Lidhur me çështjen penale të adresuar nga denoncuesja R. B., subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në drejtim të identifikimit të elementëve të veprës tjetër penale të vetëgjyqësisë, ashtu sikurse kishte konstatuar edhe gjykata mbi vendimet e subjektit, të cilat rezultuan të prishura dhe iu kthyen subjektit për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore, në drejtim të kualifikimit të veprës penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit shfaq mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në tregues të tillë si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, si dhe në aspektin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 dhe pikën 1 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

6.7 Lidhur me çështjen penale të adresuar nga denoncuesi M. M., subjekti i rivlerësimit ka munguar të kryejë veprimet hetimore në kohë, sikurse ka disponuar me vendim për kryerje të aktit të ekspertimit për verifikim në terren të apartamenteve, në datën 29.12.2021, pas tre muajve nga regjistrimi i procedimit penal datë 27.09.2021 dhe se gjykata në dy raste e ka kthyer vendimin e prokurorisë, për hetime të mëtejshme.

⁶ Shtetasi K.U. rezulton përfundimisht i dënuar për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm” me vendimin nr. {***}, datë 16.05.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

7. Komisionerja Publike i ka bashkëlidhur ankimit rekomandimin për ushtrim ankimi të ONM-së, me nr. {***} prot., datë 16.10.2024, si pjesë përbërëse e të cilit janë paraqitur⁷ në Kolegj kopje të njësuara të fashikujve si vijojnë⁸:
- i. procedimi penal nr. {***}/2017, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në ngarkim të shtetasve M. T., R. T. dhe E. T.;
 - ii. vendimi nr. {***}, datë 17.07.2017, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, që lidhet me caktimin e masës së sigurisë ndaj shtetasit M. T.;
 - iii. vendimi nr. {***}, datë 17.07.2017, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, që lidhet me caktimin e masës së sigurisë ndaj shtetasit E. T.;
 - iv. vendimi nr. {***}, datë 09.07.2019, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, lidhur me gjykimin e procedimit penal nr. {***}/2017;
 - v. procedimi penal nr. {***}/2017, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në ngarkim të shtetasve A. L., L. L., A. S. dhe B. Gj.;
 - vi. vendimi nr. {***} datë 20.06.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për gjykimin e procedimit penal nr. {***}/2017;
 - viii. kallëzimi penal nr. {***}/2017, që i përket shtetasit A. B., ndaj shtetasve M. T., E. T. dhe K. T.;

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit dhe legjitimiti i ankuesit

8. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës.
9. Trupi gjykues çmon të analizojë çështjen e legjitimitit të Komisioneres Publike në paraqitjen e ankimit, bazuar edhe në pretendimin e ngritur nga subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, *se çdo tentativë për të rivlerësuar apo rishtjelluar të njëjtat gjetje apo sjellje profesionale që janë analizuar më parë, vjen në kundërshtim me ndalimin e shprehur në nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe përbën tejkalim të kompetencës kontrolluese të Komisionerit Publik, si dhe cenim të parimit kushtetues “ne bis in idem”*. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit në vendimin nr. 31, datë 18.11.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Elvin Gokaj.
10. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, referuar dispozitave kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe

⁷ Me shkresën e ONM-së nr. {***} prot., datë 14.11.2024, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 14.11.2024.

⁸ Përcjellë vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr. {***} prot., datë 04.01.2024, regjistruar pranë ONM-së me nr. {***} prot., datë 12.01.2024 dhe nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr. {***} prot., datë 09.01.2024, regjistruar pranë ONM-së me nr. {***} prot., datë 11.01.2024.

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, vëren se parashikimi i nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilit: “2. Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit E, paragrafi 2, të Aneksit.”, ndalon në mënyrë të drejtpërdrejtë ushtrimin e së drejtës së ankimit nga subjekti i rivlerësimit dhe Komisionerja Publike për vendimet e marra, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, i cili ka gjetur transpozim në nenet 58, pika 2 dhe 60 të ligjit nr. 84/2016, parashikon dhënien e masës disiplinore të pezullimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe, me këtë rast, detyrimin e tij për ndjekjen e një programi edukimi njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës. Dhënia e kësaj mase disiplinore nënkupton që procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit është kryer për të tria kriteret e vlerësimit dhe subjekti ka rezultuar me nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe kontrollin e figurës, por në vlerësimin e aftësive profesionale janë evidentuar mangësi, të cilat mund të plotësohen nëpërmjet ndjekjes prej tij të programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës. Pra, ndalimi i ushtrimit të së drejtës së ankimit të Komisioneres Publike dhe subjektit të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, i jep disponimit të Komisionit për vlerësimin e këtij kriteri statusin e një vendimi përfundimtar të formës së prerë.

11. Në zbatim të dispozitave të mësipërme kushtetuese dhe ligjore, në rastin konkret, trupi gjykues vëren se Komisioni, pasi përfundoi hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit për të tria kriteret e rivlerësimit, me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 17.10.2023, vendosi: 1. *Pezullimin nga detyra të znj. Flora Çela për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës; 2. Në përfundim të këtij trajnimi, pas administrimit të rezultateve të arritura nga subjekti, Komisioni do të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar mbi të tria kriteret e vlerësimit. 3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe Shkollës së Magjistraturës brenda 30 ditëve pas kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. 4. Ky vendim është i paankimueshëm, bazuar në pikën 2 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë vendim të ndërmjetëm, Komisioni ka parashtruar gjetje në 9 (nëntë) çështje penale⁹ të trajtuara në kuadër të aftësive profesionale, të cilat u konsideruan si mangësi në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit që mund të plotësohen duke ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, bazuar në nenin E dhe në pikën 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës. Ndërsa në lidhje me dy kriteret e tjera, ky vendim përcakton se Komisioni do të shprehet në vendimin përfundimtar, pasi subjekti të ketë përfunduar programin e edukimit njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës. Ky vendim i është njoftuar¹⁰ subjektit të rivlerësimit, ONM-së dhe Shkollës së Magjistraturës, si dhe është publikuar në faqen zyrtare të Komisionit¹¹ më datë 23.11.2023. Me shkresën nr. {***} prot., datë 01.08.2024, Shkolla e*

⁹ (i) kallëzimi penal nr. {***}/2015 që i përket shtetasit F. M.; (ii) procedimi penal nr. {***}, datë 18.09.2017, regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasve I. dhe M. B.; (iii) kallëzimi penal nr. {***}, datë 27.07.2021, adresuar nga denoncuesja M. Ç.; (iv) procedimi penal nr. {***}, datë 16.07.2017, adresuar nga denoncuesja K. M.; (v) procedimin penal nr. {***}, datë 27.09.2021, që lidhet me denoncimin e shtetasit M. M.; (vi) procedimi penal nr. {***}, datë 18.12.2019, adresuar nga denoncuesja R. B.; (vii) procedimi penal nr. {***}, datë 07.07.2018, adresuar nga denoncuesi V. H.; (viii) çështja penale nr. {***} akti, datë 07.02.2022, që lidhet me denoncimin e shtetasit K. B.; (ix) procedimi penal nr. {***}, datë 13.07.2017, referuar informacioneve nga burime të hapura.

¹⁰ Përkatësisht me shkresat nr. {***} prot., nr. {***} prot., dhe nr. {***} prot., datë 23.11.2023.

¹¹ <https://kpk.al/znj-flora-cela-prokurore-ne-prokurorine-prane-gjykates-se-shkalles-se-pare-te-juridiksonit-te-pergjithshem-vlore/30/>

Magjistraturës i ka përcjellë Komisionit vlerësimin përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Çela, pas përfundimit të programit (02.10.2023 – 17.05.2024), të miratuar nga Këshilli Pedagogjik e më pas nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. {***}, datë 30.07.2024, sipas së cilit, *subjekti i rivlerësimit ka arritur rezultate të mira, duke i kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit*. Me vendimin nr. 802, datë 23.09.2024, Komisioni, pasi administroi vlerësimin e ardhur nga Shkolla e Magjistraturës, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e ndërmjetëm të Komisionit, vlerësoi se ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale dhe konkludoi se në vlerësimin tërësor të çështjes ka arritur nivel të besueshëm në të tria kriteret e rivlerësimit, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela. Ndaj këtij vendimi të Komisionit, që ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, ka ushtruar ankim Komisionerja Publike.

12. Bazuar në sa më lart, trupi gjykues vëren se, në rastin konkret, ankimi i Komisioneres Publike kundërshton vendimin nr. 802, datë 23.09.2024, të Komisionit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit dhe jo vendimin e ndërmjetëm nr. 4, të datë 17.10.2023. Për këtë arsye, si dhe mbajtur në konsideratë natyrën e kompetencës kushtetuese të Komisioneres Publike, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, si një ndër institucionet rivlerësuese dhe përfaqësues i interesit publik, por që nuk është pjesë e hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se Komisionerja Publike legjitimohet në ushtrimin e ankimit ndaj vendimit përfundimtar të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, si një ankim në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në ndryshim nga rasti i cituar nga subjekti i rivlerësimit në parashtrime, për të cilin Komisioni masën disiplinore të pezullimit nga detyra dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit për një periudhë njëvjeçare e ka dhënë me vendim përfundimtar¹², në rastin konkret, këtë masë disiplinore, Komisioni e ka dhënë me vendim të ndërmjetëm, përpara se të jepte vendimin përfundimtar për konfirmimin e saj në detyrë. Kjo situatë e ndryshme faktike dhe ligjore nuk e ndalon Kolegjin të kontrollojë bazueshmërinë dhe drejtësinë e vendimit përfundimtar të Komisionit, pasi në të kundërt do të pamundësohej funksioni kushtetues i tij për kontrollin e vendimeve të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisioneres Publike.
13. Në vazhdim të këtij arsyetimi dhe në analizë të pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se rishqyrtimi i kriterit profesional, i cili ka qenë objekt rivlerësimi, për të cilin është marrë një vendim i formës së prerë, sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës, cenon parimin kushtetues *ne bis in idem*, trupi gjykues vëren se Komisionerja Publike ka kundërshtuar vendimin e Komisionit, duke kërkuar shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi, sipas saj, rrethanat e konstatuara nga Komisioni në 6 (gjashtë) çështje penale, së bashku me gjetjet e saj në procedimet penale nr. {***}/2017 dhe nr. {***}/2017, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, edhe sikur të mos ishin të tilla që çonin në aplikimin e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit duhet të gjejë zbatim neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke kërkuar përfundimisht zbatimin e nenit 61, pikat 4 dhe 5 të këtij ligji. Në këtë drejtim, trupi gjykues sjell në vëmendje se neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon si një nga rastet e shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, kur nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive

¹² Vendim i Komisionit nr. 187, datë 24.07.2019, i kontrolluar nga Kolegji me vendimin (JR) nr. 31, datë 18.11.2020.

nëpërmjet programit të trajnimit. Ndodhur përpara një vendimi përfundimtar për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se referuar parashikimeve të nenit 59, pika 2 e ligjit nr.84/2016, sipas së cilit edhe nëse një subjekt rivlerësimi arrin në nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, institucionet e rivlerësimit nuk mund ta konfirmojnë në detyrë nëse konstatohet se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se rrethanat dhe gjetjet e evidentuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, të risjella edhe në ankimin e Komisioneres Publike, duhet të ishin analizuar nga Komisioni, jo vetëm nën dritën e aftësive profesionale, por duhet të ishin analizuar, gjithashtu, edhe nëse veprimet ose mosveprimet e subjektit të rivlerësimit cenonin besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Mbështetur në këtë arsyetim, trupi gjykues e gjen jorelevante thirrjen për zbatim të parimit *ne bis in idem* nga ana e subjektit të rivlerësimit.

14. Bazuar në sa më lart, trupi gjykues vlerëson se Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit nr. 802, datë 23.09.2024, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

b) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

15. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me ankimin e Komisioneres Publike ndaj vendimit të Komisionit nr. 802, datë 23.09.2024, për subjektin e rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve, në datat 07.07.2025 dhe 14.07.2025, në të cilat subjekti i rivlerësimit u asistua edhe nga avokatja Romina Zano.
16. Në seancën gjyqësore publike të datës 07.07.2025, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerit Publik, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
17. Trupi gjykues, në zbatim të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm të datës 07.07.2025, vendosi të çelë hetimin gjyqësor të çështjes dhe të administrojë aktet e depozituara në formën e duhur ligjore nga ONM-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 14.11.2024, si dhe aktet shkresore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur parashtrimeve¹³. Pasi palët deklaruan se nuk kishin

¹³Me parashtrimet e datës 30.06.2025, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 30.06.2025, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: -- Fashikujt e procedimeve penale nr. {***}/2021, nr. {***}/2018, nr. {***}/2018, nr. {***}/2019 dhe materialit kallëzues nr. {***}/2021; -- Vendim nr. {***}, datë 18.08.2017 dhe shkurtim vendimi nr. {***}, datë 06.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me shtetasin R. A., si dhe apel ndaj vendimit nr. {***}, datë 06.10.2017; -- Kërkesë për vlefësim arresti dhe caktim mase sigurimi, vendim gjykate nr. {***}, datë 17.07.2017, apel ndaj vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 26.03.2018 dhe konkluzione mbi përfundimin e çështjes në lidhje me shtetasin K. T.; -- Kërkesë për vlefësim arresti dhe caktim mase sigurimi dhe vendim gjykate nr. {***}, datë 17.07.2017, në lidhje me shtetasin L. L.; -- Kërkesë për vlefësim arresti dhe caktim mase sigurimi dhe vendim gjykate nr. {***}, datë 17.07.2017, në lidhje me shtetasin A. S.; -- Kërkesë për vlefësim arresti dhe caktim mase sigurimi, dhe vendim gjykate nr. {***}, datë 17.07.2017, në lidhje me shtetasin A. L.; -- Kërkesë për vlefësim arresti dhe caktim mase sigurimi dhe vendim gjykate nr. {***}, datë 17.07.2017, në lidhje me shtetasin B. Gj.; -- Apel ndaj vendimit nr. {***}, datë 20.06.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; --

kërkesa të tjera procedurale, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit gjyqësor dhe i ftoi ato në paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare.

18. Në seancën gjyqësore publike të datës 14.07.2025, në konkluzionet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme deklaroi se edhe gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e ankimit, duke i kërkuar përfundimisht Kolegjit, ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 802, datë 23.09.2024 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela. Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, i kërkoi Kolegjit mospranimin e ankimit si të pabazuar në prova e ligj dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit.
19. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues analizoi shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike në ankim, parashtrimet e bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, parashtrimet e bisedimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi shqyrtoi provat e administruara në dosjen gjyqësore gjatë hetimit administrativ dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, e që iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve, duke arsyetuar e konkluduar si vijon.

V. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për vlerësimin e aftësive profesionale

20. Komisioni, në vendim, pasi i ka trajtuar mangësitë e konstatuara në 9 (nëntë) çështje penale (cituat në poshtëshënimin 9 të këtij vendimi), si të meta në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, i ka konsideruar të tilla që shërohen nëpërmjet programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim, Komisioni, pasi administroi vlerësimin e Shkollës së Magjistraturës, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kaluar mangësitë e evidentuara nga

*Vendim i datës 27.04.2018 mbi kërkesën për zëvendësimin e prokurorit nga ushtrimi i ndjekjes penale; -- Kërkesë nr. {***}, datë 26.06.2025 dhe kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 26.06.2025, e Prokurorisë Vlorë; -- Shkresë e Drejtorisë së Policisë Qarku Vlorë e datës 16.12.2006 drejtuar Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe informacion për referimin e veprës penale datë 16.12.2006; -- Shkresë nr. {***} prot., datë 18.11.2013, e Drejtorisë së Policisë Qarku Vlorë drejtuar Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe informacion për referimin e veprës penale datë 17.11.2013; -- Vendim i datës 26.04.2018, i Prokurorisë për Krime të Rënda, për shpalljen e moskompetencës lëndore; -- Shkresë e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë nr. {***} prot., datë 07.02.2017, drejtuar Prokurorisë për Krimet e Rënda; -- Informacion për referimin e veprës penale datë 06.02.2017; -- Vendim i datës 26.06.2018 i Prokurorisë për Krime të Rënda, për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve; -- Vendim i datës 11.10.2018 i Prokurorisë për Krimet e Rënda, për shpalljen e moskompetencës lëndore dhe kalimin e akteve; -- Urdhër i datës 07.06.2017 i Prokurorisë për Krime të Rënda, për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale; -- Informacion për referimin e veprës penale datë 23.12.2016; -- Urdhër i datës 02.04.2018 i Prokurorisë për Krime të Rënda, për regjistrimin e procedimit penal -- Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 03, datë 19.03.2020; nr. 04, datë 24.03.2020; nr. 05, datë 08.04.2020; nr. 06, datë 27.04.2020; -- E-mail zyrtar i Prokurorisë së Përgjithshme datë 18.03.2020, 14.03.2020, 17.03.2020, 09.03.2020, 16.07.2020 dhe 21.12.2020; -- Urdhra të Prokurorisë Vlorë nr. {***} prot., datë 01.02.2017; nr. {***} prot., datë 29.09.2023; nr. {***} prot., datë 08.09.2022, dhe nr. {***} prot., datë 11.11.2024; -- Urdhra të Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}/2018, nr. {***}/2018 dhe nr. {***}/2018; -- Vendime të KLP-së nr. {***}, datë 19.03.2019; nr. {***}, datë 23.07.2021; nr. {***}, datë 15.04.2020; nr. {***}, datë 24.02.2020; nr. {***}, datë 27.01.2021; nr. {***}, datë 16.09.2021; nr. {***}, datë 05.07.2021 dhe nr. {***}, datë 24.02.2020; -- Vërtetim nr. {***} prot., datë 24.06.2025, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë; -- Vendime për vlerësimet e punës së prokurorit 2012 – 2016; -- Urdhër i Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 07.12.2018, për transferim të Oficerit të Policisë Gjyqësore; -- Shkresë nr. {***} prot., datë 04.06.2025, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë; -- Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 09.06.2025, e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; -- Vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë nr. {***}, datë 04.06.2024, nr. {***}, datë 19.01.2021 dhe nr. {***} datë 05.12.2022; -- Vendim nr. {***}, datë 05.10.2021, i Gjykatës së Apelit Vlorë; -- Shkresë nr. {***} akti, datë 02.11.2023, për dërgimin e dosjes penale Gjykatës së Apelit.*

Komisioni, ka konkluduar se *subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.*

21. Komisionerja Publike ka kundërshtuar, në ankim, konkluzionin e mësipërm, me pretendimin se mangësitë e konstatuara nga Komisioni në 6 (gjashtë) prej çështjeve penale të trajtuara prej tij, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, konkretisht: në procedimin penal nr. {***}, datë 13.07.2017, procedimin penal nr. {***}, datë 18.09.2017, si dhe 4 (katër) çështjet penale të adresuara nga denoncuesit M. Ç., V. H., R. B. dhe M. M., së bashku me gjetjet e saj nga analizimi i dosjeve të plota të procedimit penal nr. {***}/2017 dhe nr. {***}/2017, janë të atilla që nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të edukimit të Shkollës së Magjistraturës. Pasi ka parashtruar këto gjetje, Komisionerja Publike ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që bëjnë të mundur aplikimin e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.* Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj.
22. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar shkakun e ankimit, duke argumentuar se në mungesë të një vlerësimi objektiv dhe të provuar për veprimtari që përbëjnë devijim nga sjellja etike dhe ligjore e kërkuar nga një magjistrat, ky konkluzion mbetet i pambështetur në fakte dhe norma juridike. Sipas saj, vlerësimi i besimit të publikut te drejtësia nuk mund të jetë një standard abstrakt apo perceptim i paprovuar, por duhet të mbështetet mbi sjellje konkrete që bien ndesh me detyrimet e ligjit, dhe çdo vlerësim për shkelje të standardeve duhet të bazohet në sjellje të identifikueshme, të vazhdueshme dhe me ndikim real negativ mbi perceptimin publik. Në vlerësimin e subjektit, mungesa e individualizimit të shkeljeve konkrete nga Komisionerja Publike, si dhe interpretimi i tyre në mënyrë të zgjatur dhe jashtë kornizës së ligjit nuk përmbushin kriteret për të konstatuar *“cenim të besimit të publikut”*. Në kundërshtim të konkluzionit të Komisioneres Publike, subjekti i rivlerësimit ka evidentuar edhe një sërë elementësh të tillë si: menaxhimi në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive prej saj i një ngarkese të konsiderueshme hetimore gjatë viteve 2018-2022¹⁴; vlerësimi *“Shumë mirë”* për performancën profesionale për periudhën 2012-2016 dhe pa u ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore, si dhe përfundimi me sukses i trajnimit njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës. Këta tregues, sipas subjektit, të kombinuar me faktin se në secilën prej çështjeve të analizuara nuk është konstatuar ndonjë shkelje e natyrës së rëndë, e cila të ketë sjellë pasoja të pakthyeshme apo të ketë cenuar të drejtat themelore të shtetasve, hedhin poshtë çdo pretendim për një *“model të dobët pune”*, siç pretendohet nga Komisionerja Publike.
23. Trupi gjyqësor, në shqyrtim të shkakut të ankimit të Komisioneres Publike, në drejtim të cenimit të besimit të publikut, të konfirmuar edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në qëndrimin e tij përfundimtar në Kolegj dhe të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe në vijim të

¹⁴ *Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se: gjatë vitit 2018 ka trajtuar gjithsej 391 materiale procedurale, në përfundim të vitit janë mbartur vetëm 37 procedime penale; në vitin 2019 janë trajtuar 360 materiale me një mbetje për vitin pasardhës prej vetëm 47 procedimesh; gjatë vitit 2020 në kushtet e veçanta të krijuara nga pandemia globale Covid-19, janë trajtuar 377 materiale prej të cilave janë mbartur 75 procedime; për vitin 2021 ka trajtuar 452 materiale procedurale duke lënë në mbetje për vitin vijues 126 materiale; në vitin 2022 janë trajtuar 320 materiale të regjistruara, nga të cilat janë mbartur 90 procedime. Gjithashtu, ka vepruar në më shumë se një seksion, në seksionin e të miturve dhe të ekzekutimeve të vendimeve penale, seksionin e marrëdhënieve juridikionale me jashtë, seksionin e veprave penale të përgjithshme.*

sa arsyetuar në paragrafin 13 të këtij vendimi, me qëllim për të vlerësuar nëse gjetjet e evidentuara në ankim janë të atilla që cenojnë besimin e publikut, mori në analizë çështjet penale të adresuara nga Komisionerja Publike.

Lidhur me procedimin penal nr. {}/2017¹⁵***

24. Komisioni ka konstatuar se¹⁶: “[...] *Duket se subjekti në vlerësimin e kërkesës për pushimin e çështjes edhe për shtetasin R. T. është mjaftuar vetëm me hetimin lidhur me transkriptimet e përgjimeve telefonike dhe gjurmët papilare të këtij shtetasi. Në analizë të akteve në dosje, në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, pavarësisht vendimmarrjes përfundimtare, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme dhe të plota hetimore në drejtim të qartësimit të çdo rrethane dyshuese të dalë nga hetimi*”.
25. Komisionerja Publike, në ankim, krahas konstatimeve të mësipërme të Komisionit, bazuar në analizimin e fashikullit së plotë të këtij procedimi penal nr. {***}/2017 dhe të një tjetër procedimi penal të lidhur me të, me nr. {***}/2017, ka parashtruar në ankim edhe një sërë gjetjesh, në drejtim të: (i) veprimtarisë jo të plotë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit për përcaktimin e përgjegjësisë penale për personat e dyshuar; (ii) kualifikimit jo të duhur të veprës penale dhe mënyrën e trajtimit të rastit në disa procedime penale të veçanta; (iii) masave të sigurisë të papërshtatshme të caktuara ndaj personave të dyshuar, konkretisht si vijojnë.
26. *Në drejtim të kryerjes së një veprimtarie jo të plotë hetimore, Komisionerja Publike ka konstatuar se: (i) DVR-ja e sekuestruar më datë 13.07.2017, gjatë kontrollit në restorantin “{***}” {***}, Vlorë, u ekzaminua më datë 15.06.2018, pothuajse një vit pas sekuestrimit¹⁷; (ii) nuk duket që të jenë ndërmarrë hapa procedurale apo hartuar akte në të cilat t’i delegohen detyra hetimore policisë gjyqësore, në kundërshtim me nenin 294/b “Infiltrimi në përbërje të grupit kriminal” apo neni 304 “Veprimtaria hetimore e prokurorit”, të Kodit të Procedurës Penale. Dosja përmban vetëm procesverbalin e datës 22.08.2018, në të cilin referohen disa informacione mbi veprime bazike hetimore; (iii) pavarësisht se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka përcjellë më datë 18.12.2017 një analizë të të dhënave për llogari të hetimit telefonik, në lidhje me procedimin penal, të administruara nga kompanitë celulare, nga organi i prokurorisë nuk duket të jenë bërë përpjekje për të kontaktuar personat mbartës të këtyre numrave, për të marrë dëshmitë e tyre; (iv) shtetasi M. T. është marrë në pyetje vetëm më datë 12.04.2019, pothuajse dy vite nga sekuestrimi i bimëve narkotike, pas arrestit në flagrancë dhe nuk rezulton e dokumentuar “Ftesa për paraqitje” ndaj tij, në kundërshtim me parashikimet e nenit 308 të Kodit të Procedurës Penale; (v) nuk duken të jenë ndërmarrë hapa hetimorë në drejtim të përgjegjësisë së shtetasit R. T., pavarësisht se ai ishte formalisht i regjistruar si i dyshuar për veprën penale dhe nuk është hetuar në lidhje me asistet e tij financiare pavarësisht lidhjeve që kishte si anëtar i familjes T.; (vi) pavarësisht informacioneve, nuk duken të jenë ndërmarrë veprime të tjera hetimore në drejtim të përcaktimit të mundësisë financiare të gjithë pjesëtarëve të familjes T. për të krijuar pasuritë e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar,*

¹⁵ Ky procedim penal është analizuar nga Komisioni referuar informacioneve nga burime të hapura në faqen: https://tiranapost.al/{***}

¹⁶ Shih paragrafët 47.17 dhe 47.18 të vendimit të Komisionit.

¹⁷ Referuar procesverbalit të këqyrjes, rezulton se : [...] lidhet aparati me ushqyesin e saj dhe lidhet me energjinë elektrike. Pasi shtypet butoni i ndezjes së aparatit vërehet se aparati nuk ndizet. Gjë tjetër me interes nga këqyrja nuk rezultoi [...].

trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (në vijim “ligji nr. 10192, datë 03.12.2009”), duke përjashtuar nga analiza financiare shtetasin R. T., shtetas i cili ishte i regjistruar si person nën hetim¹⁸; (vii) nuk duket të jenë ballafaquar shenjat e gishtave në qeset ku u sekuestruan 10 ton bimë narkotike, me shenjat e gishtave në bazën e të dhënave të Policisë së Shtetit, për të kuptuar se kujt i përkisnin ato. Në dosje gjendet i administruar një vendim për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik i datës 25.06.2018, rreth një vit më vonë nga data e sekuestrimit; (viii) nuk duket se është kryer ndonjë veprim hetimor lidhur me përcaktimin e pronësisë së koshereve të bletëve që ndodheshin shumë afër me tokën ku u sekuestrua bima narkotike, për të cilën banorët e zonës deklarorin se është në pronësi të shtetasit M. T.. Dëshmitë e banorëve të zonës rreth shtëpisë ku policia sekuestroi bimët narkotike janë marrë në korrik 2018, sërish rreth një vit pas veprimeve operationale të policisë. Vetëm më datë 04.07.2018, prokuroria i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Vlorë, për marrjen e informacionit mbi parcelat e tokës në pronësi të shtetasit M. T..

27. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në qëndrimin e tij përfundimtar në Kolegj, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë gjetjet e Komisioneres Publike në drejtim të veprimtarisë hetimore të kryer prej tij, duke argumentuar, ndër të tjera, se: (i) pajisja elektronike DVR duhet t’i ishte nënshtruar ekspertimit nga ekspertët e laboratorit të Policisë Shkencore, të cilët janë të vetmit që mund të përcaktojnë nëse kjo DVR mund të gjenerojë ose jo të dhëna apo pamje, foto, video etj., vendim ekspertimi ky që siç u provua dhe gjatë debatit gjyqësor nuk rezultoi të jetë urdhëruar nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pavarësisht informacioneve lidhur me mosjustifikimin e pasurive, mbeti e provuar mosndërmarrja e asnjë veprimi hetimor në funksion të regjistrimit të procedimit pasuror mbi personat e hetuar në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, edhe pse ky i fundit nuk kërkon provimin e veprës penale bazë ose vendim fajësie të formës së prerë; (iii) nuk rezultoi të jetë marrë një vendim i dedikuar për krahasimin dhe ekspertimin daktiloskopik, për të urdhëruar Institutin e Policisë Shkencore që të bëjë krahasim të dedikuar mes gjurmëve të përfuara gjatë procesit të ekzaminimit të provave të gjetura në vendin e ngjarjes (qese, armë etj.) dhe gjurmëve të marra subjekteve nën hetim, të cilët nuk figurojnë të skeduar në *database-in* e Institutit të Policisë Shkencore, por është mjaftuar me krahasimin automatik të sistemit.
28. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të konstatimeve të mësipërme, e ka konsideruar veprimtarinë hetimore të kryer prej saj në përputhje të plotë me objektin e çështjes dhe nivelin e dyshimit të arsyeshëm në atë fazë, duke argumentuar sa vijon.

28.1. Përdorimi i metodave speciale të hetimit, përfshirë infiltrimin, referuar legjisllacionit përkatës¹⁹, është i justifikuar vetëm në çështje të rëndësishme të trafikimit ndërkombëtar të organizuar, kur mungojnë mundësitë alternative për sigurimin e provave dhe identifikimin e të implikuarve. Në rastin konkret, kur procedimi penal është regjistruar për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, përveç faktit që nga informacioni policor nuk ishin referuar elementë të një grupi të strukturuar apo organizate kriminale apo forme të veçantë bashkëpunimi, ndërhyrja e drejtpërdrejtë e policisë në vendin e ngjarjes, pa komunikuar që në fillim me prokurorinë, vështirësoi çdo veprim tjetër të mundshëm proaktiv, pasi aplikimi i

¹⁸ Për veprat penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

¹⁹ Subjekti i rivlerësimit ka cituar ligjin nr. 8750, datë 26.01.2001, “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikut të substancave narkotike dhe psikotrope” dhe udhëzimin e përbashkët nr. 960 prot., datë 11.04.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe nr. 809, datë 09.04.2003, të Ministrisë të Rendit Publik.

metodave speciale në fshehtësi dhe sekreti hetimor është ai që udhëheq hetimin e rasteve komplekse. Ndërkaq, argumentohet se në asnjë prej vendimeve të shpalljes së moskompetencës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për çështje që përmbanin indicie mbi elementët e veprës penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike”, nuk është aplikuar metoda speciale e hetimit përmes infiltrimit.

28.2. Në lidhje me kryerjen e ekspertimit daktiloskopik mbi qeset plastike të sekuestruara, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se janë kryer një sërë ekspertimesh të natyrës daktiloskopike, balistike dhe biologjike nga të cilat nuk janë përfutur elemente materiale që të sillnin identifikim të drejtpërdrejtë të autorësisë nëpërmjet gjurmëve daktiloskopike apo biologjike. Sipas subjektit, për shkak të numrit të madh të qeseve dhe pamundësisë objektive për përpunimin e tyre në tërësi, është vepruar në përputhje me udhëzimin që rregullon mënyrën e përzgjedhjes së mostrave për ekspertim, duke kërkuar me shkresën nr. {***} prot., datë 18.09.2017, nga Instituti i Policisë Shkencore realizimin e përzgjedhjes së mostrave dhe po atë ditë është mbajtur procesverbali përkatës nga oficerët e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, në bashkëpunim me ekspertët e Institutit të Policisë Shkencore. Si rezultat është administruar akti i ekspertimit daktiloskopik nr. {***}, datë 13.10.2017, nga i cili rezulton se nuk janë përfutur gjurmë papilare të vlefshme për identifikim. Edhe një nga gjurmët që ka rezultuar e vlefshme për analizë nuk është përputhur me asnjë prej personave të arrestuar apo hetuar, përfshirë shtetasin R. T..

28.3. Në lidhje me veprimet verifikuese mbi pronësinë e koshereve të bletëve, shpjegohet se në fashikull është administruar shkresa nr. {***} prot., datë 15.02.2019, e lëshuar nga Njësia Administrative Shushicë, në të cilën konfirmohet se në territorin përkatës nuk janë të regjistruar apo të evidentuar fermerë që merren me mbarështimin e bletëve.

28.4. Elementi mbi mungesën e “Ftesës për paraqitje” ndaj personit nën hetim M. T., sipas subjektit të rivlerësimit, nuk përbën një shkelje procedurale sa kohë që personat nën hetim kanë qenë nën efektin e masës shtrënguese të sigurimit personal “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

28.5. Pajisja DVR, sipas subjektit të rivlerësimit, është sekuestruar që në momentin e konstatimit, duke u verifikuar menjëherë si jo funksionale për efekt të përfitimit të ndonjë informacioni të dobishëm për hetimin. Ky konstatim, sipas saj, është bërë në kuadër të një hetimi proaktiv, dhe fakti që akti i këqyrjes formale është materializuar në një datë të mëvonshme nuk ka pasur ndikim në vlefshmërinë apo integritetin e provave, për sa kohë që nuk ka rezultuar të jenë gjeneruar të dhëna të përpunueshme nga kjo pajisje.

28.6. Në lidhje me shtetasin R. T., shpjegohet se janë administruar të dhëna nga policia për pasurinë e tij, por hetimi pasuror, gjithashtu, është i pavarur dhe nuk është i detyrueshëm proceduralisht të kryhet në mënyrë të njëhershme me procedimin kryesor. Pra, sipas subjektit, nëse do të rezultonin të dhëna për faktin penal kryesor, në çdo moment të mëvonshëm, mund të rinisë hetimi pasuror, duke e zgjeruar atë në drejtim të çdo pasurie të dyshuar që rrjedh nga aktiviteti kriminal.

28.7. Në lidhje me fillimin dhe ecurinë e procedimit penal pasuror, nga subjekti i rivlerësimit, argumentohet se në rastin konkret fillimi i hetimit pasuror është iniciuar mbi bazën e informacionit të referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë. Sipas saj, për shtetasin R. T., në fazën paraprake të hetimit, nuk është referuar ndonjë dyshim i drejtpërdrejtë, ndonëse të

dhëna mbi pasuritë e tij rezultojnë të jenë mbledhur gjatë analizës së përgjithshme në materialin referues nga strukturat e policisë e, në këtë kontekst, përqendrimi i hetimit pasuror është orientuar në drejtim të pasurive të dy personave të arrestuar dhe të anëtarëve të familjes së tyre, sipas certifikatës familjare. Më tej, argumentohet se, sipas nenit 287 të Kodit Penal, për të ekzistuar figura e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, duhet të provohet në radhë të parë ekzistenca e një veprë penale parësore nga e cila kanë rrjedhur të ardhura apo produkte, si dhe që këto të ardhura të jenë përdorur në një nga format konkrete të përcaktuara në anën objektive të dispozitës ligjore²⁰. Në lidhje me gjendjen kriminale të shtetasve M. dhe E. T., për të cilët është kërkuar zhvillimi i hetimit pasuror, shpjegohet se janë administruar të dhëna zyrtare nga INTERPOL, nga të cilat këta shtetas nuk figurojnë të evidentuar për ndonjë aktivitet kriminal në disa prej shteteve të BE-së, si dhe nuk rezultojnë në kërkim ndërkombëtar. Pra, nuk u provua, sipas subjektit, që këta shtetas të jenë të dënuar për ndonjë veprë penale apo të jenë të përfshirë në ndonjë veprimtari kriminale, por rezultoi se në ngarkim të tyre kanë ekzistuar vetëm informacione policore, pra, ka ekzistuar vetëm dyshimi sipas shërbimeve të policisë.

29. Në analizë të gjetjeve në drejtim të veprimtarisë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, referuar akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, si dhe akteve të fashikullit të procedimit penal nr. {***}/2017, të administruar në cilësinë e provës gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

29.1. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, referuar informacioneve nga burime të hapura²¹ lidhur me një aksion policor të vitit 2017 në fshatin Llakatund dhe Drithas, Vlorë, në të cilin u sekuestruan 20 ton drogë dhe u arrestuan 9 persona si të dyshuar, pjesëtarë të një grupi trafikantësh, me njoftimin e rezultateve të hetimit të datës 28.09.2023, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me këtë ngjarje të hetuar prej saj²². Pas administrimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me çështjen, të shoqëruara me disa akte, që i përkisnin procedimeve penale nr. {***} të vitit 2017 dhe nr. {***} të vitit 2017, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme dhe të plota hetimore në trajtimin e këtij procedimi penal, si pasqyruar më lart, në paragrafin 24 të këtij vendimi.

29.2. Nga aktet e dosjes së procedimit penal nr. {***}/2017, të administruar në cilësinë e provës në Kolegj, rezultojnë se:

29.2.1. Me urdhrin e datës 13.07.2017, subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Prodhim dhe

²⁰ Subjekti ka cituar vendim unifikues nr. 1, viti 2007, mbi hetimin pasuror dhe vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.13, datë 11.05.2017.

²¹ https://tiranapost.al/{***}

²² Komisioni ju kërkon: i) të jepni shpjegime të detajuara lidhur me ngjarjen e bërë publike; ii) të sqaroni rrethanat e çështjes objekt hetimi; iii) të sqaroni dhe dokumentoni kërkimin tuaj për masën e sigurimit personal për secilin shtetas, të sqaroni arsyet, faktet dhe rrethanat mbi të cilat u bazuat për të kërkuar masën e sigurimit personal detyrim paraqitje në policinë gjyqësore, në raport me rrezikshmërinë e veprës penale të publikuar dhe dënimin e parashikuar për të; iv) të qartësoni nëse në vijim ka pasur kërkesa të tjera për zëvendësim të masës së sigurimit personal, dhe çfarë është vendosur për to, duke depozituar edhe çdo dokumentacionin mbështetës. - Po ashtu, Komisioni ju kërkon: i) të shpjegoni nëse kjo çështje është hetuar më tej nga ana juaj. Në varësi të kësaj të fundit, Komisioni ju kërkon: ii) të qartësoni dhe dokumentoni veprimet hetimore të kryera, njoftimin e akuzës, kohën e zgjatjes së kryerjes së hetimeve, kërkimin tuaj gjyqësor për themelin e çështjes, vendimmarrjen e organit gjyqësor, si dhe statusin aktual të çështjes. - Për trajtimin me objektivitet të rastit, Komisioni ju kërkon të mbështesni me dokumentacion (urdhra, vendime, procesverbale, kërkesa drejtuar gjykatës, diskutim/e përfundimtare, njoftim akuze, vendim/e gjyqësore, etj.) të gjithë shpjegimet tuaja lidhur me këtë çështje, objekt hetimi.

mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga nenet 283/2 dhe 278/1 të Kodit Penal, si dhe regjistrimin e emrave të shtetasve M., E. dhe R. T., si të dyshuar për këto vepra penale.

29.2.2. Në kuadër të veprimeve të para hetimore, më datë 13.07.2017²³, nga kontrolli i ushtruar në lokalin “{***}”, në lagjen “{***}”, në Vlorë, është sekuestruar në cilësinë e provës materiale: *“Një pajisje elektronike e tipit DVR, me ngjyrë të zezë [...]. Pajisja ka të montuar edhe ushqyesin e saj me ngjyrë të zezë”*. Me vendimin e datës 15.07.2017, subjekti i rivlerësimit ka vleftësuar të ligjshëm sekuestrimin e këtij aparati. Këqyrja e tij është bërë më datë 15.06.2018, sipas procesverbalit të këqyrjes së aparatit DVR, në të cilit përshkruhet se: *“Kjo pajisje është sekuestruar në datën 13.07.2017 në restorantin “{***}” në pronësi të shtetasit L. T., me adresë në lagjen “{***}” Vlorë. Nga ana jonë lidhet aparati me ushqyesin e saj dhe lidhet me energjinë elektrike. Pasi shtypet butoni i ndezjes së aparatit vërehet se aparati nuk ndizet. Gjë tjetër me interes nga kqyrja e aparatit nuk rezultoi. Kqyrja filloi në orën 12:00 dhe përfundoi në orën 13:00 të po kësaj date”*.

29.2.3. Pas arrestimit në flagrancë, më datë 14.07.2017²⁴, të shtetasve M. T. dhe E. T., subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e datës 15.07.2017, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë vleftësimin e ligjshëm të arrestimit, si dhe caktimin ndaj tyre të masës së sigurimit “Detyrim për paraqitje”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Të dy këta shtetas janë pyetur në datën 14.07.2017, në cilësinë e personave ndaj të cilëve zhvillohen hetimet. Lidhur me shtetasin M. T., pas caktimit ndaj tij të masës së sigurimit personal “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, sipas vendimit nr. {***}, datë 17.07.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ky shtetas është pyetur sërish në prani të avokatit, në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime më datë 12.04.2019, ndërkohë që nuk rezultojnë akte për njoftimin e tij. Komunikimi i vetëm i dokumentuar me këtë shtetas është përmes shkresës nr. {***} prot., datë 12.06.2019, ku i përcillet për njohje kërkesa për pushimin e procedimit penal. Për shtetasin R. T., subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar gjykatës më datë 14.07.2017 vleftësimin dhe lejimin e përgjimit të numrit në përdorim të tij për një afat 15-ditor. Gjithashtu, rezulton se më datë 18.04.2019 këtij shtetasi i janë marrë për krahasim edhe gjurmët papilare, ndërsa më datë 19.04.2019 është pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime

29.2.4. Në datën 03.10.2017, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë i ka përcjellë²⁵ Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, materialin referues për regjistrimin dhe fillimin e procedimit pasuror për shtetasit E. T. dhe M. T., në të cilat, ndër të tjera, referohet: *Në ngarkim të shtetasit E. M. T. [...] lindur e banues në fshatin Drithas, Vlorë, janë regjistruar të dhëna kriminale në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike që prej vitit 2015; Në ngarkim të shtetasit M. A. T. [...] lindur e banues në fshatin Drithas, rezultojnë të dhëna të regjistruara në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike që prej vitit 1999. Janë identifikuar pasuri të cilat nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike dhe dyshohet se janë përfituar si rrjedhojë e veprimtarisë kriminale të kryer nga shtetasit e lartpërmendur. [...] Sipas burimeve konfidenciale, është mësuar se këta shtetas disponojnë prona të tjera në qytetin e Vlorës dhe në Tiranë. Gjithashtu disponojnë shuma të konsiderueshme parash të cilat i ka të depozituara në banka të ndryshme të cilat mund të jenë edhe në emër të familjarëve të vëllezërve T.. Më tej,*

²³ Referuar procesverbalit për sekuestrimin e sendeve të datës 13.07.2017.

²⁴ Referuar procesverbaleve për arrestimin në flagrancë.

²⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 03.10.2017.

në përgjigje të kërkesës së organit të prokurorisë, mbi ushtrimin e ndonjë veprimtarie të dyshimtë kriminale, precedentë penalë apo dënime për ndonjë vepër penale për anëtarët e familjes T. është administruar në janar të vitit 2018 informacion për të dhëna të regjistruara për përfshirje në veprimtari kriminale në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, të shtetasve M. e E. T. për tendencën e trafikimit të lëndëve narkotike.

29.2.5. Në kuadër të hetimeve paraprake, me kërkesat e datave 25.09.2017, 29.09.2019, 06.10.2017, drejtuar bankave dhe një sërë institucionesh²⁶, është kërkuar informacion mbi pasuritë e shtetasve M. T., E. T. dhe anëtarë të tjerë të familjes T., si dhe informacion mbi gjendjen gjyqësore, precedentë penale etj²⁷. Në këto kërkesa nuk rezulton i përfshirë emri i shtetasit R. T.. Në vijim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pas administrimit të përgjigjeve të kompanive të telefonisë celulare “Vodafone” dhe Plus Mobile”, mbi komunikimet telefonike për disa numra telefoni për periudhën 10.07.2017 – 15.07.2017, ka kërkuar më datë 08.11.2017 nga Drejtoria e Policisë së Shtetit: *“Analizimin e të dhënave teknike, tabulateve telefonike për numrat celularë objekt hetimi (për të cilët është kërkuar informacioni) [...]”*. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i ka përcjellë organit të prokurorisë më datë 18.12.2017, procesverbalin për analizimin e të dhënave telefonike në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017. Nga aktet në dosje nuk rezulton që të jenë kontaktuar apo marrë deklaratimet e përdoruesve të numrave të telefonit.

29.2.6. Në vijim, me kërkesën e datës 12.10.2017, është kërkuar informacion nga Njësia Administrative Shushicë, për prona të regjistruara në pronësi apo përdorim në fshatin Drithas, të shtetasve M. T., V. T., R. T., Xh. T. dhe Q. L.. Më datë 04.07.2018, është kërkuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, kopje e planit të rilevimit, sipas formularit nr. 6, në fshatin Drithas, Vlorë, për shtetasin M. T.. Në muajt qershor korrik 2018 janë marrë deklaratime të banorëve të zonës F. T., B. Gj., S. A., I. A. dhe më datë 18.07.2018 të shtetasve K. T. e R. H.. Më datë 04.02.2019, është kërkuar informacion nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Ushqimit, Informacionit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Njësia Administrative Shushicë, Vlorë, mbi personat që kanë koshere bletësh në fshatin Drithas, Vlorë. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve ka informuar në datën 11.02.2019 se është në pamundësi për të dërguar të dhënat e kërkuara për shkak se sistemi “RUDA” është i bllokuar nga Ministria e Bujqësisë, ndërsa Njësia Administrative Shushicë ka informuar në datën 15.02.2019 se në fshatin Drithas nuk ka fermer që merret me rritjen dhe mbarështimin e bletëve.

29.2.7. Sipas relacionit “Për përfundimin e veprimeve të deleguara për procedimin penal nr. {***} të vitit 2017” të datës 22.09.2018, Oficeri i Policisë Gjyqësore ka informuar mbi përfundimin e veprimeve të deleguara për procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, konkretisht: *“Më datë 22.05.2018, me shkresën nr. {***}, datë 22.05.2018, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka dërguar urdhrin për delegimin e veprimeve hetimore për procedimin penal nr. {***}/2017 [...] Në lidhje me detyrat e deleguara nga ana jonë janë kryer këto veprime: 1. Janë pyetur në cilësinë e personit që kanë dijeni për veprën penale shtetasit B. Gj., F. (J.) T., S. A.; I. A., R. H. dhe K. A.; 2. Janë dërguar në IPSh Tiranë vendimet e ekspertimit kimik dhe daktiloskopik. 3. Janë administruar aktet e ekspertimit kimik dhe vlerësues të provave nr.*

²⁶ Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, Aluiznit, QKB-së, Zyrrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme etj.

²⁷ Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Zyrrës Qendrore Kombëtare Interpol Tirana, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve etj.

{***}, datë 09.07.2018 dhe nr.{***}, datë 10.07.2018. 4. Është administruar tabela fotografike e këqyrjes së vendit të ngjarjes. 5. Nuk u bë e mundur pyetja e ish inspektorit të policisë së zonës”. Nuk rezulton i administruar në dosje urdhër për delegimin e veprimeve hetimore për procedimin penal nr.{***}/2017.

29.2.8. Në kërkesën e datës 23.04.2019, për pushimin e procedimit penal nr.{***}/2017, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në parashtrimin e veprimeve hetimore të kryera në kuadër të hetimit të çështjes, ndër të tjera, pasqyrohet se: “Është administruar akti i ekspertimit daktiloskopik vlerësues nr. {***}, datë 24.07.2017, nga i cili konkludohet se nga përpunimi i armëve dhe krehrave e fishekëve objekt ekspertimi nuk janë përftuar gjurmë papilare të vlefshme për identifikim. [...] Sipas aktit të ekspertimit nr. {***}, datë 24.07.2017, në provat materiale të administruara në vendin e ngjarjes nuk janë administruar gjurmë papilare për identifikim. Po kështu, në aktin e ekspertimit daktiloskopik vlerësues nr.{***}, datë 24.07.2017, pjesët e filmit gjurmë kopjues nuk janë përftuar gjurmë të vlefshme për identifikim, ndërsa një gjurmë është e vlefshme, e cila nga krahasimi në sistem nuk rezulton të jetë e shtetasve persona në hetim. [...] Nga akti i ekspertimit vlerësues nr.{***}, datë 13.10.2017, rezulton se nga ekzaminimi i 15 qeseve objekt ekspertimi nuk janë administruar gjurmë papilare për identifikim. [...]” Gjithashtu, nga aktet rezulton se me vendimin “Për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik” të datës 25.06.2018 është vendosur ekspertimi daktiloskopik për një sasi me peshë 33 kg, të futura në dy qese plasmasi me ngjyrë të zezë. Në këtë vendim, parashtrohet se: “Nga sasia e përgjithshme e lëndës narkotike të sekuestruar u morën me përzgjedhje për shkak të prezencës së lagështirës dhe baltës në të gjithë sasinë e lëndës narkotike të sekuestruar, pasi nuk mund të kryhet ekspertimi kimik dhe daktiloskopik, i bërë me vendimin e datës 14.07.2017, si dhe për arsye se nuk mund të çohet e gjithë sasia për ekspertim për shkak të ngarkesës së madhe që ka aktualisht IPSh Tiranë me provat materiale për ekspertim”. Sipas aktit të ekspertimit vlerësues me nr. {***}, datë 10.07.2018, bazuar në vendimin e OPGj-së së datës 25.06.2018, rezulton se nga trajtimi kimio-fizik i materialeve nuk u përfatuan gjurmë papilare të vlefshme për identifikim.

30. Në konsideratë të rrethanave të përshkruara më sipër, në drejtim të veprimtarisë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit gjatë trajtimit të procedimit penal nr. {***}/2017, trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë konstatimet e Komisioneres Publike, konfirmuar edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë Posaçme, mbi veprime hetimore të pamjaftueshme dhe të kryera jo në kohë, të tilla si: (i) këqyrja me vonesë, pothuajse pas një viti i pajisjes elektronike DVR, e sekuestruar në datën 13.07.2017 gjatë kontrollit në restorantin “{***}” dhe mosurdhërimi i ekzaminimit të mëtejshëm të saj nga ekspertët e laboratorit të Institutit të Policisë Shkencore; (ii) mungesa e ballafaqimit të shenjave të gishtave në qeset ku u sekuestruan bimët narkotike, me shenjat e gishtave në bazën e të dhënave të Policisë së Shtetit, duke u mjaftuar vetëm me krahasimin automatik të tyre në sistem, si dhe marrja me vonesë e vendimit të datës 25.06.2018, për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik. Lidhur me këto gjurmë u konstatua, gjithashtu, mos nxjerrja e një vendimi për krahasimin dhe ekspertimin daktiloskopik, për të urdhëruar Institutin e Policisë Shkencore që të bëjë një krahasim të dedikuar mes gjurmëve të përfthuara nga provat e gjetura në vendin e ngjarjes dhe gjurmëve të marra subjekteve nën hetim të cilët nuk janë të skeduar në *database-n* e këtij instituti; (iii) përjashtimi i të dyshuarit R. T., i cili ishte një nga tre shtetasit në ngarkim të të cilit ishte regjistruar procedimi penal nr. {***}/2017, nga kërkimi i të dhënave pasurore në kuadër të hetimit të pasurive të anëtarëve të familjes T. (M. dhe E. T.)

ndaj të cilëve Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë kishte referuar nisjen e hetimit pasuror, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar; (iv) marrja në pyetje me vonesë, më datë 12.04.2019, pas pothuajse dy vitesh nga sekuestrimi i lëndës narkotike, e shtetasit M. T., i cili ishte, gjithashtu, një nga tre personat ndaj të cilit ishte regjistruar procedimi penal dhe mungesa e dokumentimit të njoftimit të këtij shtetasi; (v) nuk rezultojnë të dokumentuara përpjekjet për të marrë deklaratimet e shtetasve që ishin përdorues të numrave të telefonit, sipas analizës së të dhënave të përcjella për llogari të hetimit telefonik nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; (vi) marrja me vonesë e dëshmimeve të banorëve të zonës, pas pothuajse një viti dhe kërkimi me vonesë, pas pothuajse një viti e gjysmë, i të dhënave në lidhje me përcaktimin e pronësisë së koshereve të bletëve që ndodheshin afër vendit ku u sekuestrua lënda narkotike.

31. Komisionerja Publike, në ankim, ka konstatuar se *trajtimi i rastit nga subjekti i rivlerësimit, për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, më së paku, nxjerr në pah mangësi dhe hetim të dobët, i cili ka bërë të pamundur zbardhjen e plotë të mekanizmit të ngjarjes dhe rolit e përgjegjësive së secilit pjesëmarrës në të.* Sipas saj, rrethanat e ngjarjes lidhur me: (i) informacionet e qëndrueshme dhe veprimet operacionale të organeve ligjzbatuese; (ii) sasinë e konsiderueshme të lëndëve narkotike të sekuestruara; (iii) faktin që lëndët narkotike ishin të paketuara dhe gati për transport; (iv) rrezikshmërinë dhe sasinë e armëve të konfiskuara; (v) faktit që mes të dyshuarve kishte dhe zyrtarë me funksione publike (prania e një zyrtari të fshatit dhe oficerëve të policisë ndër të arrestuarit), janë tregues që rasti duhej trajtuar, sipas nenit 283/a “Trafikimi i narkotikëve” dhe nenit 284/a “Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale”, të Kodit Penal. Në vlerësimin e Komisioneres Publike, mbetet e paqartë pse një ndër veprimet operacionale më të mëdha antikanabis që është ndërmarrë në Shqipëri u nda në procedime të veçanta duke e zbehur rëndësinë e rastit dhe kurrë nuk u referua në prokurorinë kompetente, e cila në atë kohë ishte Prokuroria për Krime të Rënda.
32. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në qëndrimin e tij përfundimtar në Kolegj, në mbështetje të konstatimeve të Komisioneres Publike, u shpreh se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë debatit gjyqësor në Kolegj, dështoi t’i përgjigjej pyetjes nëse ajo kishte mundur të zbulonte në përfundim të hetimit disavjeçar të këtij procedimi penal se cili ishte destinacioni i gjithë kësaj sasive lënde narkotike, duke nxjerrë në pah mangësi dhe hetim të dobët të kryer në hetimin e çështjes penale. Në mbështetje të këtij qëndrimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka argumentuar se subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me praktikën gjyqësore, referuar formës së bashkëpunimit në realizimin e veprës penale, nuk ka analizuar, si dhe nuk ka marrë parasysh të gjithë elementët që bëjnë dallimin midis një bashkëpunimi të thjeshtë dhe atij të posaçëm, siç në këtë rast janë: sasinë e mëdha të lëndës narkotike, *modus operandi*, aftësia për të kultivuar lëndën narkotike, aftësia për të grumbulluar të gjithë lëndën narkotike dhe përgatitja për t’u transportuar, procese këto të cilat nuk mund të realizohen në një bashkëpunim të thjeshtë. Në vlerësimin e tij, rasti ishte plotësisht brenda juridiksionit të Gjykatës për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, ndërkohë që Prokuroria e Krimeve të Rënda ka ushtruar aktivitetin edhe për rreth dy vite të tjera pas regjistrimit të këtij procedimi penal, dhe ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale ishin pa ndikim në këtë proces.
33. Subjekti i rivlerësimit, duke saktësuar fillimisht se procedimi penal është referuar dhe regjistruar për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni

283/2 i Kodit Penal, dhe jo për veprën penale të “Kultivimi i bimëve narkotike”, ka kundërshtuar konstatimet e evidentuara në ankim dhe qëndrimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke argumentuar se në rastin konkret nuk rezulton të ketë pasur asnjë devijim në drejtim të kualifikimit penal, për sa kohë nuk përmbushen kriteret për t’u trajtuar sipas nenit 283/a “Trafikimi i narkotikëve” të Kodit Penal, pasi: *i.* nuk rezulton të jenë administruar indicie apo prova që provojnë karakterin transnacional të veprimtarisë së konstatuar, në kuptim të kriterit dallues të nenit 283/1 të Kodit Penal, sipas vendimit unifikues nr. 3, datë 17.01.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; *ii.* sasia e lëndës narkotike, pjesërisht e dëmtuar apo në gjendje të degraduar, nuk përmbush në vetvete kërkesën cilësore për përshkallëzimin e veprës në kuptimin e “Trafikimit të narkotikëve”, sipas nenit 283/a të Kodit Penal; *iii.* nuk rezulton të jenë ngritur dyshime, a disponuar informacione, për elementë që plotësojnë figurën e veprës penale të “Organizimit dhe drejtimit të organizatave kriminale”, të parashikuar nga neni 284/a i Kodit Penal, për sa kohë nuk janë evidentuar të dhëna që vërtetojnë ekzistencën e një strukture të qëndrueshme, me rol të përcaktuar të anëtarëve apo veprimtari të vazhduar në kohë, sipas kërkesave të dispozitës penale. Qëndrimi i mbajtur nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme se lënda ishte e destinuar për trafikim dhe, për rrjedhojë, vepra duhet të ishte kualifikuar, sipas nenit 283/a të Kodit Penal, në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit bie ndesh, jo vetëm me praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë për rastet e ngjashme, cituar më lart, por edhe me qëndrimet e mbajtura nga ish-Prokuroria për Krime të Rënda në vendimet për shpallje moskompetence, në të cilat është sanksionuar qartazi se ekzistenca e veprës penale të trafikimit të lëndëve narkotike, sipas nenit 283/a të Kodit Penal kërkon prova specifike dhe të drejtpërdrejta për elementin transnacional të veprimtarisë, çka nuk është evidentuar në rastin konkret e, për pasojë, nuk mund të pretendohet një kualifikim penal më i rënduar. Sipas subjektit të rivlerësimit, referuar praktikës hetimore, jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, si dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional, nuk mund të arrihet në përfundimin se kemi të bëjmë me një bashkëpunim të formës së posaçme të sanksionuar nga neni 28 i Kodit Penal, por përkundrazi kemi të bëjmë me format klasike të bashkëpunimit, të cilat nuk kanë të njëjtin intensitet rrezikshmërie dhe të njëjtën shkallë të organizimit. Në rastin konkret, sipas subjektit, dyshimet paraprake janë ngritur vetëm në drejtim të dy personave M. dhe E. T. si autorë të mundshëm të veprës penale objekt hetimi, rrethanë që përjashton në mënyrë të qartë ekzistencën e një grupi të strukturuar kriminal. Sa i takon mostransferimit të çështjes në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, në vlerësimin e subjektit, nuk ka qenë rezultat i një qëndrimi të qëllimshëm për të devijuar juridiksionin, por lidhet me situatën juridike dhe institucionale në të cilën ka ndodhur fakti, pasi çështja objekt hetimi ka ndodhur më datë 13.07.2017, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, më datë 01.08.2017, periudhë në të cilën prokuroria funksiononte si një strukturë e centralizuar, ku drejtuesi i prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm ushtronin njëkohësisht kompetenca mbi ecurinë e hetimeve dhe kualifikimin juridik të veprave penale.

34. Në vijim të qëndrimit të saj, lidhur me trajtimin e rastit në procedime penale të veçanta, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se çdo procedim penal regjistrohet mbi bazën e një materiali referues/kallëzues në varësi të kohës së referimit, institucionit të referimit dhe datës së regjistrimit të tyre. Sipas saj, nëse gjatë hetimit konstatohen elementë të përbashkët mes procedimeve penale, që hetohen nga i njëjti prokuror apo prokurorë të ndryshëm, merrej vendim bashkimi nga drejtuesi i prokurorisë, sipas neneve 92 dhe 79 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin e procedimit penal nr. {***}/2017, në ngarkim të shtetasit M. dhe E. T., shpjegohet se materialet janë referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, ndërsa në rastin

e procedimit penal nr. {***}/2017, në ngarkim të shtetasve A. L., L. L., A. S. dhe B. Gj., materiali është referuar nga ShÇBA. Nga subjekti, gjithashtu, shpjegohet se nga informacionet e dy institucioneve referuese nuk janë ngritur dyshime për lidhje mes dy ngjarjeve dhe nuk rezultojnë të dhëna për bashkëpunim të thjeshtë apo ndonjë formë të veçantë bashkëpunimi mes personave të arrestuar në të dy procedimet, e as prova që të vërtetojnë ndonjë lidhje midis dy procedimeve penale, si në momentin e parë të konstatimit, ashtu dhe gjatë hetimit paralelisht në të njëjtën kohë.

35. Në mbështetje të pretendimeve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur²⁸ me parashtrimet në Kolegj, ndër të tjera, edhe akte nga disa procedime penale që i përkasin viteve 2006, 2013, 2016, 2017 dhe 2018, si informacione për referimin e veprës penale pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, urdhra regjistrimi procedimi penal të kësaj prokurorie apo vendime të kësaj të fundit për shpalljen e moskompetencës, të cilat u administruan në Kolegj në cilësinë e provës, nga të cilat rezulton se në këto raste Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka shpallur moskompetencën lëndore dhe kalimin e akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për hetimin e procedimeve penale për kryerjen e veprave penale të tilla si “Moskallëzimi i krimit”, “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror” apo “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, ndërkohë që ka disponuar me regjistrim procedimi penal për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a të Kodit Penal.

36. Nga analizimi i akteve të fashikullit të hetimit administrativ dhe akteve të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, trupi gjykues konstaton se:

36.1 Në seancën dëgjimore të datës 12.10.2023, të zhvilluar në Komision, i pyetur nga vëzhguesi ndërkombëtar, lidhur me faktin se përse çështja nuk është dërguar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, por është mbajtur në prokurorinë e rrethit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *[...] ka qenë periudha kur krimet e rënda ka qenë duke u mbyllur pasi prokurorët dhe të gjithë materialet ishin duke kaluar pranë prokurorisë së rretheve të ndryshme, pra është mbyllur si prokurori në atë periudhë. Dhe ndodhën edhe ndryshimet e Kodit të Procedurës në 2017-ën. [...] Janë dënuar për prodhim shitje lëndësh narkotike, shpërdorim detyre kam përshtypjen [...].*

36.2 Nga aktet e procedimit penal nr. {***}/2017 dhe nr. {***} të vitit 2017, të administruar në Kolegj në cilësinë e provës, trupi gjykues, veç sa parashtruar më lart në paragrafin 29.2, konstaton se:

36.2.1 Me urdhrin e datës 13.07.2017, subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, pasi është njohur me ngjarjen e kësaj date, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga nenet 283/2 dhe 278/1 të Kodit Penal, si dhe regjistrimin e emrave të shtetasve M. T., E. T. dhe R. T. të dyshuar për këto vepra penale. Në këtë urdhër, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar rrethanat e ngjarjes së datës 13.07.2017, si vijojnë: *Nga ana e Drejtorisë së Policisë Vlorë, seksioni kundër narkotikëve dhe trafiqeve të paligjshme, është marrë informacion mbi sasi të konsiderueshme lënde nartotike të llojit canabis sativa të ndodhur në fshatin Drithas, Vlorë. Menjëherë me marrjen e këtij informacioni, është organizuar grupi i punës duke shkuar shërbimet në vendin e ngjarjes, me prezencë edhe të prokurorit. Konkretisht*

²⁸ Cituar në poshtëshënimin nr. 13 të këtij vendimi.

objekt këqyrje është një banesë në fshatin Drithas Vlorë, e pabanuar aktualisht, e cila sipas informacioneve rezulton të jetë në pronësi të shtetasit Z. A., shtetas ky i cili nuk jeton në Shqipëri, por është larguar jashtë vendit. [...] Gjatë këqyrjes së jashtme të banesës, rezulton se ka një çezmë, e cila është e lidhur me një tub uji për vaditjen e pemëve frutore të ndryshme dhe gjithashtu rezulton se toka përreth bahçes është e njomë dhe e vaditur në një pjesë të saj. [...] pas hapjes së portës së banesës, e cila mbante erë karakteristike të bimës narkotike *cannabis sativa*, është konstatuar se brenda saj ndodheshin thasë plastike me ngjyrë të zezë, të mbushur me sasi bime të ngjashme me atë të bimës narkotike *cannabis sativa*. Sasia e thasëve të konstatuar ka qenë e konsiderueshme dhe tre dhomat e banesës kanë qenë deri afër tavanit të banesës të mbuluar me thasë të tillë. Gjithashtu, në këtë banesë nga këqyrja që bëhet në banjën e saj janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale tre armë të tipit kallashnikov, për të cilët po merren vendimet përkatës të ekspertimit. Nga këqyrja e brendshme e banesës rezulton se janë konstatuar materiale ndihmëse për paketimin e lëndës narkotike të dyshuar, si skoc, doreza, mjete pune të tjera si dhe janë sekuestruar bidonë plastike për përpunime të mëtejshme laboratorike. [...] Nga informacionet e disponuara në rrugë operative ka rezultuar se persona të dyshuar për këtë veprë penale janë shtetasit R. T., M. T., E. T., familjarë mes tyre, të cilët dyshohen se në bashkëpunim kanë konsumuar elementët e veprës penale “Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike” dhe “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake” parashikuar nga neni 283/2 dhe 278/1 i Kodit Penal. [...].”

36.2.2 Më datë 15.07.2017, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë²⁹ i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë materialet procedurale për ngjarjen e datës 13.07.2017, që kanë të bëjnë me arrestimin e shtetasve M. T. dhe E. T. në Drithas Vlorë, për veprat penale të parashikuara nga nenet 283 dhe 278 të Kodit Penal, sipas së cilave rezulton se nga kontrolli i ushtruar në datën 13.07.2017, në banesën e pabanuar të shtetasit Z. A. u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale: “ [...] 1. 9166 kg e 600 gr. lëndë narkotike e llojit *kanabis sativa* në gjendje të thatë; 2. Një sasi lëndë narkotike prej 112 kg e 500 gr e llojit *hashash*; 3. 3 armë zjarri automatike kallashnikov model 56, 7.62 mm, [...] ; 4. Një arkë me fishekë 7.62 mm, model 56”. Gjithashtu. referohet se: “Lidhur me këtë ngjarje, më datë 14.07.2017 u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve M. T. [...] dhe E. T. [...], për arsye se nga këqyrja e vendit të ngjarjes rezultoi se banesa e tyre është në distancë të afërt me banesën e shtetasit Z. A. ku u gjet sasia me lëndë narkotike dhe ka një fushëpamje të qartë. Dyshohet se lënda narkotike e gjetur është e shtetasve M. dhe E. T.. Gjithashtu u bë shpallja e kërkimit policor të pronarit të banesës së pabanuar ku u gjet sasia e lëndës narkotike, Z. A. [...]. Dërgohen materialet procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprat penale të parashikuara nga neni 283 dhe 278 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”.

36.2.3 Më datë 16.07.2017, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë i ka përcjellë³⁰ Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, materialet procedurale lidhur me ngjarjen e datës 14.07.2017 në fshatin Drithas, për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, ku u gjet një sasi lëndë narkotike prej 696 kg e 700 gr sipas së cilave: “Më datë 14.07.2017, rreth orës 12:00 gjatë kontrollit të territorit nga ana e shërbimeve të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, në fshatin Drithas është gjetur në një përrua të këtij fshati nga ana veriore e tij, përroi është pa ujë dhe kufizohet nga ana veriore

²⁹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 15.07.2017.

³⁰ Me shkresën nr. {***} prot., datë 16.07.2017.

me parcelën me ullinj të shtetasit M. T. kurse nga ana tjetër me parcelën e shtetasit R. T. dhe Xh. T.. Gjatë kontrollit të territorit në përrua u konstatua një kasolle me plastmas, gjithashtu në afërsi të saj dhe brenda saj u gjetën të shpërndara thasë plastmasi me ngjyrë të zezë brenda të cilave kishte material në formë pluhuri të ngjashëm me atë të lëndës narkotike kanabis sativa. Gjatë kontrollit të mëtejshëm të këtij territori është konsatuar se nga ana lindore ku ndodhet parcela me ullinj e shtetasit M. T. e cila është rrethuar me tel [...] kishte një të çarë të gardhit dhe në afërsi të koshereve të bletëve që ndodheshin brenda kësaj baçe, u konstatua një thes i zi brenda të cilit kishte shtatë qese plastmasi, ku brenda tyre ka material ...në formë pluhuri i ngjashëm me atë të gjetur në përrua si ai i lëndës narkotike kanabis sativa. [...]Nga peshimi i bërë lëndës narkotike gjetur tek kosheret e bletëve si dhe në anë të gardhit u konstatua një peshë prej 26 kg e 400 gr. Më pas vazhdoi kontrolli në përrua, ku u konstatuan dyzet e tre qese plastmasi me ngjyrë të zezë me peshë 670 kg e 300 gr [...]”. Mbi bazën e këtyre materialeve, prokurorja Flora Çela ka regjistruar më datë 17.07.2017, procedimin penal për veprën penale të “Prodhim dhe shitje e narkotikëve” parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Po në datën 17.07.2017, drejtuesi i Prokurorisë Vlorë, R. T., ka vendosur bashkimin në një procedim penal të vetëm të procedimit penal nr. {***/2017 (që lidhet me ngjarjen e datës 13.07.2017, lartcitur për të cilën janë arrestuar shtetasit M. T. dhe E. T.), me procedimin penal nr. {***/2017, të regjistruar mbi bazën e materialeve të referuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë në ngarkim të shtetasit M. T.. Ky procedim penal merr nr. {***/2017 dhe me hetimin e tij ngarkohet prokurorja Flora Çela.

36.2.4 Më datë 21.07.2017, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë³¹ i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë materialet procedurale në ngarkim të shtetasit E. T., për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, bazuar në të dhënat e disponuara mbi investime në pasuri të luajtshme e të paluajtshme (banesë dhe automjete luksoze) llogari bankare, për të cilat është nxjerrë edhe një urdhër bllokimi i përkohshëm i tyre, burimi i të cilave ngre dyshime mbi origjinën e tyre, si dhe të dhënat e disponuara mbi aktivitetin kriminal në trafikimin e lëndëve narkotike të shtetasve E. T., K. T., N. T. dhe R. T.. Mbi bazën e këtyre materialeve, prokurori K. Ll. ka urdhëruar në datën 24.07.2017 regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Me vendimin e datës 25.07.2017, drejtuesi i Prokurorisë Vlorë ka vendosur bashkimin e procedimit penal nr. {***/2017 të regjistruar më datë 13.07.2017, në ngarkim të shtetasve E. T., M. T. dhe R. T., me procedimin penal nr. {***/2017, të regjistruar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në një procedim penal të vetëm me nr. {***/2017 i vitit 2017, hetimi i të cilit i ngarkohet prokurores Flora Çela.

36.2.5 Në datën 24.07.2017, në organin e prokurorisë, janë përcjellë informacione nga agjencitë ligjzbatuese për investime në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në vlera të konsideruara të larta të kryera nga shtetasi E. T., të cilat ngrenë dyshime mbi burimin e fondeve dhe aktivitetin e kryer prej tij, duke informuar se është nxjerrë edhe urdhër bllokimi i përkohshëm i transaksioneve dhe veprimeve financiare të tij dhe familjarëve.

³¹ Me shkresën nr. {***/} prot., datë 21.07.2017.

36.2.6 Më datë 03.10.2017, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë i ka përcjellë³² Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, materialin referues për fillimin e hetimit pasuror për shtetasit E. T. dhe M. T., me përmbajtje si cituar në paragrafin 29.2.4 më lart.

36.2.7 Më datë 23.04.2019³³, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 13.07.2017, në ngarkim të shtetasve M., E. dhe R. T.. Me vendimin nr. {***}, datë 09.07.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, të regjistruar për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 283/2 dhe 278 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasve M. T., E. T. dhe R. T. dhe “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar.

*Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017*

36.2.8 Më datë 14.07.2017, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme³⁴ i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, materialet procedurale për veprat penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, në bashkëpunim, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga nenet 248, 284/2 dhe 300 dhe i Kodit Penal në ngarkim të shtetasve L. L. (inspektor, me detyrë SPZ në Komisaratin e Policisë Vlorë), A. L., A. S. (inspektor, me detyrë SPZ në Komisaratin e Policisë Vlorë) dhe B. Gj. (me detyrë kryeplak i fshatit Drithas). Në këto materiale, ndër të tjera, referohet se: *“Pas informacioneve të marra në rrugë operative se punonjësi i policisë L. L. kishte kultivuar një sasi lënde narkotike në oborrin përreth banesës së tij, në datën 13.07.2017, rreth orës 19:00, pasi vajti në vendin ku bën fjalë informacioni, gjatë kontrollit të ushtruar në baçet përreth banesës ku jetonte L. L., së bashku me të vëllanë A. L. dhe prindërit e familjarët e tij në fshatin Drithas, Njësia Administrative Shushicë, u gjet e kultivuar një sasi prej 309 bimë narkotike si ato kanabis sativa. Nga këto bimë, 161 bimë ishin me gjatësi nga 80-200 cm dhe 90 bimë fidanë me gjatësi nga 0-140 cm të mbjellë në tokë 8 bimë narkotike deri në 60 cm plus dhe 50 bimë deri në 60 cm. U konstatua se kjo bimë narkotike ishte e mbjellë në baçet që rrethonin banesën ku banonte punonjësi i policisë L. L. së bashku me vëllain e tij A. L. dhe prindërit e familjarët e tyre, baçe të cilat përveç lëndës narkotike ishin mbjellë dhe me misër domate dhe mashurka”.*

36.2.9 Mbi bazën e materialeve procedurale të mësipërme, me urdhrin e datës 15.07.2017, prokurorët Flora Çela dhe E. H. kanë regjistruar procedimin penal për veprën penale të “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Kultivimi i lëndëve narkotike”, parashikuar nga nenet 248 dhe 284/2 të Kodit Penal, duke regjistruar emrat e shtetasve L. L. e A. L. të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Kultivimi i bimëve narkotike”, si dhe A. S. e B. Gj., të dyshuar për veprën penale të “Shpërdorimi i detyrës”. Më datë 05.02.2018, prokurorja Flora Çela i ka kërkuar gjykatës gjykimin e çështjes nr. {***}, të vitit 2017, me të pandehur shtetasit A. L., L. L. për veprën penale “Kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe A. S. e B. Gj. për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 20.06.2018, ka vendosur

³² Me shkresën nr. {***} prot., datë 03.10.2017.

³³ Janë zgatur afatet e hetimit me nga tre muaj përmes 7 vendimeve respektivisht të datave: 13.10.2017, 13.01.2018, 13.04.2018, 13.07.2018, 13.10.2018, 13.01.2019 dhe 13.04.2019.

³⁴ Me shkresën nr. {***} prot., datë 14.07.2017.

deklarimin fajtor të të pandehurit A. L. për kryerjen e veprës penale të “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal dhe deklarimin të pafajshëm të të pandehurve L. L., B. Gj. dhe A. S.. Pas apelit të ushtruar nga subjekti, Gjykata e Apelit, me vendimin nr. {***}, datë 06.03.2019, ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë me ndryshim vetëm në masën e dënimit për shtetasin A. L., duke e dënuar atë përfundimisht me 2 vjet e 8 muaj burgim.

36.3 E pyetur gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, se cili kishte qenë, pas hetimit disavjeçar të këtij procedimi penal, destinacioni i gjithë sasisë së lëndës narkotike, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga këqyrja, gjysma e sasisë së lëndës kishte qenë e kalbur, ndërkohë që në vlerësimin e saj ka qenë për shitje, por nuk ka rezultuar e provuar nëse ka qenë për shitje transnacionale apo për shitje të brendshme. Ndërsa pyetjes - *A mund të bëhet gjithë ky aktivitet, kultivim, grumbullim, paketim, ambalazhim dhe gati për transport në kuadër të një bashkëpunimi të thjeshtë?* - subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur - *Varet nga sa i zoti është autori që e kryen atë, nuk e di.*

37. Bazuar në situatën e fakteve të parashtruara më lart, në drejtim të pretendimit të Komisioneres Publike, në ankim, dhe të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme gjatë gjykimit në Kolegj *se rasti duhej trajtuar për veprat penale “Trafikimi i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal dhe “Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale”, parashikuar nga neni 284/a i Kodit Penal e, për pasojë, duhej transferuar për kompetencë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda*, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se mungesa e një veprimtarie të plotë hetimore ka pamundësuar/penguar një vlerësim e kualifikim juridik të veprës penale, i cili në varësi të fakteve që mund të provoheshin, mund të ishte i ndryshëm nga momenti fillestar i regjistrimit të saj. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe rrethanat e faktit të tilla si: (i) sasia e konsiderueshme e lëndës narkotike të sekuestruar; (ii) gjetja e saj në disa forma, si në formë të paketuar dhe gati për transport, ashtu dhe në formë të kultivuar, në një fshat me shtrirje gjeografike relativisht të vogël; (iii) sekuestrimi së bashku me lëndën narkotike edhe të një sasive armësh dhe municioni; (iv) informacionet e organeve ligjzbatuese për dy nga shtetasit e dyshuar; (v) fakti që mes të dyshuarve kishte tre zyrtarë me funksione publike në drejtim të kontrollit e zbatimit të ligjit. Këto rrethana, të rezultuara nga kontrolli i veprimtarisë së subjektit të rivlerësimit në drejtim të përmbushjes së detyrave në zgjidhjen e çështjes dhe ushtrimin e ndjekjes penale, që nuk përbën zëvendësim të logjikës dhe interpretimit të subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin e trupit gjykues, do të duhet të orientonin hetimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me formën e bashkëpunimit me të cilën ishte kryer kjo veprimtari kriminale, pra, nëse ishim para një forme të thjeshtë apo të posaçme bashkëpunimi.

38. Trupi gjykues mori në analizë edhe konstatimin tjetër të Komisioneres Publike, në ankim, se *masa e sigurisë e kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, për të dyshuarit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, nisur nga rrethanat e ngjarjes duket tërësisht e papërshtatshme, veçanërisht duke pasur në konsideratë se për një nga të dyshuarit, shtetasin M. T. rezultonin të dhëna të regjistruara në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike që prej vitit 1999. Në mbështetje të këtij konstatimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në qëndrimin e tij përfundimtar në Kolegj ka argumentuar se në kërkesat “Për vlerësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit”, për shtetasit M. T. dhe E. T., të hartuara nga subjekti i rivlerësimit, nuk rezulton të jetë bërë individualizimi i rrethanave për secilin prej të hetuarve, që kanë të bëjnë me rrezikshmërinë shoqërore të autorëve, veprave etj. Sipas tij, pavarësisht rrethanave të rastit, si dhe kërkesës së subjektit të rivlerësimit për vlerësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë*

për shtetasit M. T. dhe E. T., subjekti i rivlerësimit, në trajtimin e rastit, ka zbehur, duke vënë në dyshim ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, ekzistenca e të cilit është kusht pa të cilin nuk mund të vendoset një masë sigurie, pavarësisht llojit të saj.

39. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të konstatimeve dhe qëndrimeve të mësipërme, ka parashtruar se në rastin konkret është vlerësuar se mungon rreziku real dhe i provuar i shmangies nga drejtësia apo helmimi i provave, të cilat ishin administruar gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, mbështetur në argumente të tilla si: *i.* shtetasit M. T. dhe E. T. nuk janë kapur në flagrancë në banesën ku është konstatuar dhe sekuestruar lëndë narkotike apo në kryerje e sipër të veprës penale; *ii.* banesa në fjalë nuk është në pronësi apo në përdorim të tyre; *iii.* banesa e shtetasit M. T. ndodhet në të njëjtin fshat, por jo ngjitur me vendin e ngjarjes; *iv.* hetimi është ndjekur me metoda proaktive; *v.* nga kontrolli i banesave (në fshat dhe në qytet) nuk janë gjetur sende të kundërligjshme që ta lidhnin me veprën penale; *vi.* shtetasit R. dhe E. T. nuk rezultojnë të banonin në fshatin ku është zbuluar lëndë narkotike; *vii.* nga sekuestrimi dhe verifikimi i pajisjeve telefonike nuk janë administruar të dhëna të vlefshme për hetimin penal. Për këtë arsye, në përputhje me kriteret e nenit 234 të Kodit të Procedurës Penale, është caktuar ndaj tyre masa e sigurimit “Detyrim për paraqitje”, si masa më efektive dhe më proporcionale në raport me të dhënat e çështjes dhe rrezikun konkret për hetimin penal.
40. Në vlerësim të konstatimeve të Komisioneres Publike në drejtim të masave të sigurimit, nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. {***}/2017, të administruara në cilësinë e provës gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, trupi gjykues konstaton se:

40.1 Në datën 15.07.2017, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë vlefësimin e ligjshëm të arrestimit të flagrancë të shtetasve E. T. dhe M. T., si dhe caktimin ndaj tyre të masës së sigurimit “Detyrim për paraqitje”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Në këto kërkesa, në drejtim të kushteve dhe kriterëve për caktimin e masës së sigurimit personal, ndër të tjera, arsyetohet se: [...] *si të dyshuar për kryerjen e kësaj veprë penale janë arrestuar shtetasit M. T. dhe E. T., atë e bir. [...] Në bazë të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, askush nuk mund t’i nënshtrohet masave të sigurimit personal nëse në ngarkim të tij nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm dhe i bazuar në prova, si dhe në rastet kur ka shkaqe padënueshmërie ose shuarje të veprës penale. Nuk rezultojnë, gjithashtu, që në këtë rast të ekzistojë ndonjë shkak padënueshmërie apo shuarje të veprës penale, si dhe i dyshuari M. T./E. T., rezultojnë të jetë madhor dhe i përgjegjshëm para ligjit penal. Në këto rrethana jemi në kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal, pasi në ngarkim të shtetasit M. T./E. T., ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se: 1) ndodhemi përpara një fakti penal të mësipërm; dhe se 2) ky fakt dyshohet të jetë kryer nga ky shtetas, në bashkëpunim me persona të tjerë. Për shtetasin E. T., arsyetohet se: [...] për shkak të rrethanave të kryerjes së veprës penale (banesë e cila nuk rezultojnë të jetë e tij), faktit të analizimit të këqyrjes së aparateve telefonike dhe thirrjeve telefonike, si dhe nevojës për kryerje të hetimeve të mëtejshme, (siç janë aktet e ekspertimit) çmohet se ndaj tij duhet të caktohet masa e sigurimit me karakter shtrëngues “Detyrim për paraqitje” [...]. Lidhur me shtetasin M. T. arsyetohet se: [...] Rezultojnë se për shkak të rrethanave të kryerjes së veprës penale (banesë e cila nuk rezultojnë të jetë e tij), faktit të analizimit të këqyrjes së aparateve telefonike dhe thirrjeve telefonike, largësisë së banesës së shtetasit M. T. nga banesa ku është gjetur lëndë narkotike, përfshirë faktin që ka banesa të tjera ndërmjet, fakti që në banesën e tij nuk janë gjetur sende të dyshimta, që ta lidhin me lëndën narkotike dhe banesën ku është konstatuar ajo, si dhe nevojës për kryerje*

të hetimeve të mëtejshme (siç janë aktet e ekspertimit) çmohet se ndaj tij duhet të caktohet masa e sigurimit me karakter shtrëngues “Detyrim për paraqitje”.

40.2 Me vendimin nr. {***}, datë 17.07.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: Vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit E. T. dhe caktimin si masë sigurimi personal ndaj tij masën e kërkuar nga prokuroria “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe masën e sigurimit personal “Ndalim i daljes jashtë shtetit”, parashikuar nga neni 233 i Kodit të Procedurës Penale duke sekuestruar pasaportën dhe dokumentet e tjera të udhëtimit. Në këtë vendim, gjykata, ndër të tjera, arsyeton se: [...] Gjykata arrin në konkluzionin se vetmja masë efektivisht e aftë për të siguruar normalitetin e vazhdimësisë së hetimit dhe gjykimit eventual të çështjes është ajo e “Arrest në burg” e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, duke përjashtuar çdo lloj mase tjetër sigurimi më të butë. Pavarësisht sa më sipër, prokuroria ka parashtruar kërkesën që ndaj shtetasit nën hetim E. T. të caktohet masa e sigurimit personal “Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, Gjykata vlerëson se kjo masë nuk është e përshtatshme. [...] Gjykata ka ndalim ligjor në Kodin e Procedurës Penale në caktimin e një mase sigurimi personal më të rëndë se sa ajo e kërkuar nga Prokuroria, sikurse është rasti i “Arrest në burg” e cila është një mase sigurimi më e rëndë se sa ajo e “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” e kërkuar kjo e fundit nga prokuroria. [...] Konkretisht gjykata duke vlerësuar rreziqet nga të cilat preket procedimi penal, vlerëson të domosdoshme që brenda kufijve që përcakton neni 244/3 i Kodit të Procedurës Penale të caktojë kryesisht edhe masën e sigurimit personal “Ndalim i daljes jashtë shtetit” për personin nën hetim E. T. [...] ³⁵.

40.3 Me vendimin nr. {***}, datë 17.07.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: Vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit M. T. dhe caktimin si masë sigurimi personal ndaj tij masën e kërkuar nga prokuroria “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe caktimin si masë sigurimi personal ndaj shtetasit nën hetim M. T. masën e sigurimit “Ndalim i daljes jashtë shtetit”, parashikuar nga neni 233 i Kodit të Procedurës Penale, duke sekuestruar pasaportën dhe dokumentet e tjera të udhëtimit. Edhe në këtë vendim, gjykata ka arsyetuar si më sipër se e vetmja masë efektivisht e aftë për të siguruar normalitetin e vazhdimësisë së hetimit dhe gjykimit eventual të çështjes është “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, duke përjashtuar çdo lloj mase tjetër sigurimi më të butë ³⁶.

40.4 Veç sa më lart, i pyetur gjatë gjykimit në Kolegj, nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, nëse në vlerësimin e saj ekzistonte dyshimi i arsyeshëm për t’u caktuar masë sigurimi në rastin në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “ Kishte një dyshim të arsyeshëm mbi bazën e informacionit policor, por në bazë të Kodit të Procedurës dyshimi i arsyeshëm dhe i bazuar në prova nuk ka qenë aq i fortë sa për të caktuar atë masë sigurimi shtrënguese. [...] mbi bazën e dyshimit policor, unë nuk kam qenë dakord të bëhej arrestimi. Është bërë me iniciativë nga ana e shërbimeve të policisë”.

³⁵ Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 07.08.2017, ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, datë 17.07.2017, duke shfuqizuar vetëm disponimin mbi caktimin e masës së sigurimit personal të “Ndalimit të daljes jashtë shtetit”.

³⁶ Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 07.08.2017, ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, datë 17.07.2017, duke shfuqizuar vetëm disponimin mbi caktimin e masës së sigurimit personal të “Ndalimit të daljes jashtë shtetit”.

41. Bazuar në situatën e fakteve të parashtruara më lart, në drejtim të masave të sigurimit të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit ndaj shtetasve E. T. dhe M. T., trupi gjykues konstaton se subjekti, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë vleftësimin e ligjshëm të arrestimit të flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për paraqitje” parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasve E. T. dhe M. T., në ngarkim të të cilëve ishte regjistruar procedimi penal nr. {***/2017, cituar më lart. Në vlerësimin e trupit gjykues, sikundër ka arsyetuar edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkimi i këtyre masave në rrethanat e faktit duket se është bërë në zbatim të gabuar të kërkesave të neneve 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale, në aspektin e rrezikshmërisë së lartë shoqërore dhe rrezikut të largimit apo të sigurisë së provave nga ana e personave të hetuar. Nën dritën e këtyre parashikimeve ligjore, subjekti i rivlerësimit, në kërkimin e këtyre masave të sigurimit, nuk rezulton që të ketë pasur në konsideratë faktin që këta shtetas dyshohen njëkohësisht për dy vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore për nga objekti dhe dënimi i parashikuar apo bashkëpunimi dhe afërsia mes tyre, që passjell një nivel të caktuar organizimi dhe rrezikun e largimit apo të sigurisë së provave. Gjithashtu, trupi gjykues thekson se argumentet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, jo vetëm në kërkesat e saj për caktimin e masave të sigurimit, por edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, ishin kontradiktore, duke zbehur e vënë në dyshim edhe vetë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, ekzistenca e të cilit është kusht pa të cilin nuk mund të vendoset një masë sigurie, pavarësisht llojit të saj.
42. Një tjetër konstatim i Komisioneres Publike, në ankim, është se *deklarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore në Komision se për çështjen konkrete ka arrestuar 10 shtetas të cilët janë dënuar nga ana e saj dhe se ka dhënë më shumë se 60 vjet dënim, nuk përputhen me aktet në dosje nga të cilat rezulton se vetëm një person është dënuar, me një masë prej 2 vite e 8 muaj burg.* Edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në qëndrimin e tij përfundimtar në Kolegj, u shpreh se mbeti e provuar se lidhur me këto dy procedime penale (nr. {***/2017 dhe nr. {***/2017) është dënuar vetëm një shtetas për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe nuk rezulton asnjë i dënuar lidhur me sasinë e madhe të lëndës narkotike të sekuestruar.
43. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të konstatimit dhe qëndrimit të mësipërm, ka argumentuar në Kolegj se, sipas nenit 378 të Kodit të Procedurës Penale, roli i prokurorit është të paraqesë kërkesën për deklarimin fajtor të të pandehurit dhe përcaktimin e masës së dënimit, si dhe të ushtrojë të drejtën e ankimit në rastet kur nuk pajtohet me vendimmarrjen e gjykatës, ndërkohë që vendimmarrja mbi fajësinë ose pafajësinë i takon gjykatës. Lidhur me procedimin penal nr. {***/2017, shpjegohet se ajo ka kërkuar deklarimin fajtorë të 5 (pesë) shtetasve, duke kërkuar dënimin me 7 (shtatë) vjet burgim të shtetasit A. L., 7 (shtatë) vjet burgim të shtetasit L. L., 3 (tre) vjet burgim të shtetasit A. S., 2 (dy) vjet burgim të shtetasit B. Gj. dhe 8 (tetë) vjet burgim të shtetasit K. T.. Sipas subjektit, vendimi përfundimtar i gjykatës në gjykimin në themel, i cili merr formë të prerë pas shqyrtimit në shkallë të dytë, është rezultat i një procesi të pavarur dhe jo i mungesës së profesionalizmit nga organi i akuzës³⁷. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur me parashtrimet në Kolegj, ndër të tjera, edhe një sërë aktesh³⁸ që i përkasin procedimeve penale nr. {***/2017, në lidhje me shtetasit L. L., A. S., A. L. dhe B. Gj.; nr. {***/2017, në lidhje me shtetasin R.

³⁷ Subjekti i rivlerësimit ka cituar në mbështetje të këtij pretendimi vendimet nr. 33, datë 27.09.2021 dhe nr. 27, datë 06.07.2022, të Kolegjit.

³⁸ Këto akte janë cituar në poshtëshënimin nr.13 të këtij vendimi.

A.; si dhe nr. {***}/2017 në lidhje me shtetasin K. T., që kanë të bëjnë me aksionin në fshatin Drithas.

44. Nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit dhe aktet e administruara në Kolegj në cilësinë e provës, trupi gjykues konstaton se:

44.1 Në seancën dëgjimore të datës 12.10.2023, subjekti ka shpjeguar se: “[...] kam arrestuar diku tek 10 veta në atë operacion, të gjithë janë të dënuar nga ana ime, dhe normalisht nuk u morën asnjëherë me faktin që unë kam dhënë mbi 60 vite burg në këtë rast, por u morën që pse prokuroria nxori dy persona me masë sigurimi, që është masë sigurimi dhe nuk është masë dënimi [...]. I pyetur gjatë seancës dëgjimore nga vëzhguesi ndërkombëtar, lidhur me dënimet konkrete të kërkuara dhe llojin e veprës penale, subjekti ka shpjeguar se: [...] personat që janë dënuar kanë qenë persona që janë arrestuar në flagrancë dhe në banesën e tyre janë gjetur lëndë narkotike, kështu që nga ana ime çështjet janë dërguar për gjykim në ngarkim të diku 5 -6 persona të grupit [...] edhe 1 oficer policie, pasi në banesën e tij është konstatuar kanabis, pra, lënë narkotike, kryeplaku i fshatit dhe SPZ i zonës, pra, inspektori i zonës. Pasi unë i kam dërguar për gjykim gjykata një pjesë e ka shpallur të pafajshëm dhe unë më pas kam kryer ankimin [...].

44.2 Nga aktet e procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, rezulton se me urdhrin e datës 15.07.2017, prokurorët Flora Çela dhe E. H., mbi bazën e materialeve procedurale të përcjella nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, kanë regjistruar procedimin penal për veprën penale të “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Kultivimi i lëndëve narkotike”, parashikuar nga nenet 248 dhe 284/2 të Kodit Penal, duke regjistruar emrat e shtetasve L. L. e A. L., të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Kultivimi i bimëve narkotike”, si dhe A. S. e B. Gj., të dyshuar për veprën penale të “Shpërdorimi i detyrës”.

44.2.1. Me kërkesat e datës 15.07.2017, prokurorët i janë drejtuar gjykatës për vleftësim arresti dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, për të 4-ët këta shtetas. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 17.07.2017 dhe vendimin nr. {***}, datë 17.07.2017, ka caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në burg”, për shtetasit L. L. dhe A. L.. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 07.08.2017, ndryshoi masën e sigurimit ndaj shtetasit L. L., duke caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” e duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të tij. Ndërsa me vendimin nr. {***}, datë 07.08.2017, kjo gjykatë la në fuqi masën e sigurimit për shtetasin A. L.. Për dy shtetasit e tjerë A. S. dhe B. Gj., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimet nr. {***}, datë 17.07.2017 dhe nr. {***}, datë 17.07.2017, caktoi masën e sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Pas ankimit të dy prokurorëve ndaj këtyre vendimeve, Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi masën e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

44.2.2. Më datë 05.02.2018, prokurorja Flora Çela i ka kërkuar gjykatës gjykimin e çështjes nr. {***}, të vitit 2017, me të pandehur shtetasit A. L. dhe L. L., për veprën penale “Kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tyre me nga 7 vjet burgim, dhe A. S. e B. Gj. për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e tyre përkatësisht me 3 dhe 2 vjet burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 20.06.2018, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit A. L., për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike” dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim, i cili në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale është dënuar

përfundimisht me 4 vjet burgim, si dhe deklarin të pafajshëm të të pandehurve L. L., B. Gj. dhe A. S.. Pas apelit të ushtruar nga subjekti, Gjykata e Apelit, me vendimin nr. {***}, datë 06.03.2019, ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë me ndryshim vetëm në masën e dënimit për shtetasin A. L., duke e dënuar atë përfundimisht me 2 vjet e 8 muaj burgim.

44.3 *Nga aktet e procedimit penal me nr. {***/2017*, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 18.08.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit R. A. për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”. Nga parashtrimi i rrethanave të faktit, sipas vendimit gjyqësor, rezulton se arrestimi i këtij shtetasi u krye për shkak se *në banesën ngjitur me banesën e tij u gjet një sasi lënde narkotike me peshë 5266 kg e 800 gr siajo e kanabis sativës [...], si dhe një sasi 2.5 litra vaji i ngjashëm me atë të vajit të lëndës narkotike kanabis staiva*. Me vendimin nr. {***}, datë 06.10.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” me masën e sigurimit “Garanci pasurore” në masën 1.000.000 lekë. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, duke kërkuar lënien në fuqi të masës së sigurimit personal “Arrest në burg”. Me vendimin e datës 27.04.2018, Drejtuesi i Prokurorisë Vlorë ka vendosur pranimin e kërkesës së shtetasit R. A. për zëvendësimin e prokurores Flora Çela nga hetimi i procedimit penal me nr. {***/2017.

44.4 *Nga aktet e procedimit penal me nr. {***/2017*, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar gjykatës më datë 15.07.2017 vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për shtetasin K. T., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të cilit, së bashku me djalin e tij E. T., i është gjetur në një magazinë ngjitur me banesën, dhe në automjet, një sasi e konsiderueshme lënde narkotike përkatësisht prej 33 kg e 400 gr dhe 4.3 gr. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 17.07.2017, ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin e shtetasit K. T. dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 15.08.2017. Në konkluzionet mbi përfundimin e çështjes penale, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar gjykatës: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit K. T., për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve dhe dënimin e tij për kryerjen e kësaj veprë penale me 8 tetë vjet burgim”*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 26.03.2018, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit K. T. për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitja e narkotikëve” dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim. [...] Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të tij për një afat kohor prej 4 (katër)vjet [...]”*. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, duke kërkuar ndryshimin e tij, për sa i përket aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal dhe pranimin e kërkesës së prokurorisë në lidhje me llojin dhe masën e dënimit.

- 45.** Bazuar në sa parashtruar më lart, trupi gjykues çmon të theksojë se ndryshe nga sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore në Komision, për shkak të mangësive të sipërcituara në veprimtarinë procedurale e hetimore të kryer prej saj në cilësinë e prokurores së këtyre çështjeve, një aksion në të cilin u gjetën sasi të konsiderueshme lëndësh narkotike u përmyll me pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, për tre veprat penale të regjistruara, e për procedimin penal nr. {***} të vitit 2017 me dënimin 2 vite e 8 muaj burgim të vetëm një personi, për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal.

46. Në ankim, Komisionerja Publike ka konstatuar se *subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore në Komision ka bërë deklarime të pasakta dhe është përpjekur ti shmanget përgjigjes së pyetjes së vëzhguesit ndërkombëtar lidhur me njohjen me shtetasin M. B., për të cilin Komisioni ka administruar akte nga Prokuroria Vlorë, si rezultat i informacioneve të marra nga AKSIK, dhe për të cilën është vendosur pushimi i procedimit penal nr. {***}, datë 23.11.2017, nga një subjekt tjetër rivlerësimi. Lidhur me këtë konstatim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka mbajtur të njëjtin qëndrim në parashtrime, ndërkohë që nuk rezulton të ketë mbajtur ndonjë qëndrim në bisedimet përfundimtare. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konstatim duke shpjeguar se ajo ka dhënë sqarime të plota dhe të sinqerta lidhur me këtë çështje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore përpara Komisionit, dhe se në mungesë të një vlerësimi objektiv dhe të provuar për veprimtari që përbëjnë devijim nga sjellja etike dhe ligjore e kërkuar nga një magjistrat, ky konkluzion mbetet i pambështetur në fakte dhe norma juridike.*
47. Trupi gjykues, referuar përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi, vëren se marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me shtetasin M. B. është marrë në shqyrtim nga Komisioni në kuadër të kontrollit të figurës, në përfundim të të cilit ka arritur në konkluzionin se³⁹: *[...] në çështjen penale objekt hetimi nuk identifikohet roli i subjektit si prokuror i çështjes. Po ashtu, nuk u konstatua qoftë edhe në mënyrë indirekte ndonjë e dhënë, që të provonte ndonjë ndikim të mundshëm të subjektit te prokurori i çështjes me qëllim favorizimin e të dyshuarit. Gjithashtu, nuk u konstatua ndonjë e dhënë që mund të prezantonte indicie, fakte apo rrethana, që provonin marrëdhënie/kontakte të subjektit të rivlerësimit me shtetasin M. B.i, përpara vitit 2017 apo edhe më pas, për të konkluduar në vlerësimin tërësor të subjektit. 39.11 Në përfundim, në lidhje me kontrollin e figurës, trupi gjykues, për sa kohë nga hetimi nuk evidentoi ndonjë fakt apo provë që mund të passillte cenimin e figurës së subjektit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...]. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion, pasi ka analizuar sa vijon.*

47.1 Në raportin e kontrollit të figurës⁴⁰, i deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 14.07.2023, informohet, ndër të tjera, se për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Çela, disponohet një indikacion ku supozohet përfshirja e saj në veprimtari të kundërligjshme.

47.2 Në përgjigje të kërkesës së Komisionit mbi ekzistencën e procedimeve penale ndaj shtetasit M. B., Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka informuar⁴¹ se për këtë shtetas është regjistruar, ndër të tjera, edhe procedimi penal nr. {***/2017, hetuar nga prokurori A. K. dhe është dërguar kërkesë për pushim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 20.05.2019. Ky procedim penal është regjistruar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe është pushuar me vendimin nr. {***}, datë 16.07.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, vendim i formës së prerë datë 20.07.2019.

47.3 E pyetur gjatë hetimit administrativ, mbi marrëdhënien me shtetasin M. B., subjekti ka deklaruar⁴² se nuk ka asnjë marrëdhënie me këtë shtetas, përveç faktit që njihet si biznesmen me origjinë turke në ushtrimin e profesionit dentar në qytetin e Vlorës. Në shpjegimet mbi

³⁹ Shih paragrafët 39.10 dhe 39.11 të vendimit të Komisionit.

⁴⁰ Me shkresën nr. {***} prot., datë 13.07.2023.

⁴¹ Me shkresën nr. {***} prot./, datë 27.09.2023.

⁴² Në përgjigjen me e-mail të datës 27.09.2023.

rezultatet e hetimit, pas kërkesës së Komisionit për të dhënë sqarime në drejtim të raportit të AKSIK-së, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “Në kuptimin e nenit 3/15 të ligjit nr. 84/2016, ky subjekt nuk rezulton të jetë i përfshirë në krimin e organizuar, pasi nuk është dënuar më vendim të formës së prerë, nuk është arrestuar, nuk ka qenë asnjëherë person në hetim dhe sipas kërkesës së prokurorit dhe vendimit të gjykatës, nuk ka qenë asnjëherë i dënuar as jashtë territorit tonë”.

47.4 Në seancën dëgjimore të datës 12.10.2023, pyetjes së vëzhguesit ndërkombëtar - *Lidhur me personin A.B., i dënuar për pastrim parash dhe për të cilin çështja është pushuar në fund, në shpjegimet tuaja keni thënë që nuk keni asnjë marrëdhënie me të, por a e njihni atë si fytyrë? A do ta dallonit nëse do e shihnit rastësisht në të njëjtën rrugë në Vlorë? [...] A keni folur ndonjëherë përballë me të? - subjekti i është përgjigjur - Unë kam një periudhë shumë të gjatë kohe që punoj në Vlorë, rreth 16-17 vjet dhe normalisht si fytyrë unë e njoh personin. Nuk e di nëse ai më njeh apo jo, unë nuk jam nga ata njerëz që dal shumë publikisht nëpër media apo nëpër konferenca shtypi, jam shumë njeri i rezervuar, kjo është përgjigja ime i nderuar. [...] unë lëviz me makinë nga puna në shtëpi dhe nga shtëpia në punë nuk kam ndonjë marrëdhënie të tillë komunikimi për ti folur dhe për ta përshëndetur.[...].*

48. Nga analizimi i fakteve të sipër referuara, trupi gjykues konstaton se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore në drejtim të marrëdhënies së saj me këtë shtetas duket se ka qenë i njëjtë me qëndrimin e mbajtur gjatë hetimit administrativ, që nuk ka njohje me këtë shtetas, dhe nuk duket t'i jetë shmangur pyetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, duke pranuar njohjen si portret fizik. Për këtë arsye, si dhe në kushtet kur nga hetimi administrativ nuk ka rezultuar e provuar ndonjë marrëdhënie mes subjektit të rivlerësimit dhe këtij shtetasi, trupi gjykues i gjen të pambështetura pretendimet e Komisioneres Publike për deklarime të pasakta të subjektit të rivlerësimit e, për rrjedhojë, nuk gjen ndonjë element me ndikim në sjelljen e subjektit të rivlerësimit në drejtim të etikës, që do të afektonte perceptimin e publikut.
49. ***Në lidhje me procedimin penal nr. {***}, datë 18.09.2017***, Komisionerja Publike, në ankim, sikurse Komisioni⁴³, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit: (a) nuk ka kryer hetime shteruese, si dhe nuk ka konsideruar “sigurimin e padisë” në çështjen civile që ankuesit kanë pasur, apo çdo të dhënë tjetër të dalë gjatë hetimit dhe, për pasojë, nuk është vlerësuar drejt fakti penal⁴⁴; (b) vendimi për kryerjen e aktit të ekspertimit si detyrë e lënë nga gjykata është marrë në kohë relativisht të gjatë nga vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, datë 13.10.2020; (c) nuk pasqyrohen në dosje veprime hetimore të kryera deri në caktimin e kryerjes së aktit të ekspertimit. Në qëndrimin e tij përfundimtar në Kolegj, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u shpreh se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rrethanave të konstatuara në ankim lidhur me këtë çështje.
50. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të konstatimeve të mësipërme⁴⁵, pretendon se mangësitë e konstatuara në trajtimin procedural të çështjes penale nr. {***}/2018 nuk përputhen me jurisprudencën e Kolegjit, si shkelje me peshë të rëndë e, për rrjedhojë, konkluzioni për cenimin e besimit të publikut të drejtësia është i pabazuar në prova dhe në ligj, duke argumentuar sa vijto.:

⁴³ Shih paragrafin 44/3/w/f faqe 42-43 të vendimit.

⁴⁴ Shtetasi K. U. rezulton përfundimisht i dënuar për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, me vendimin nr. {***}, datë 16.05.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁴⁵ Në parashtrime dhe në bisedimet përfundimtare në Kolegj

50.1 Hetimi i këtij procedimi penal ka njohur ndërprerje në aspektin kohor, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar nga pandemia globale Covid-19⁴⁶, për periudhën mars-tetor 2020, si dhe lëvizjet e prokurorëve që kanë sjellë rritjen e ngarkesës në hetim që duhet të përballojë një prokuror në kushte normale⁴⁷.

50.2 Organi i akuzës ka vepruar brenda afateve të hetimit paraprak, sipas nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, që fillojnë nga data e regjistrimit të emrit të personit në hetim, e cila në këtë rast është data 01.06.2021. Nuk rezulton asnjë shkelje e dispozitave procedurale në lidhje me afatet e hetimit, që të mund të vlerësohet si e natyrës penalizuese dhe e mjaftueshme për të vendosur sanksionin disiplinor më të rëndë ndaj subjektit të rivlerësimit.

50.3 Nga shqyrtimi i tërësishëm i fashikullit hetimor dhe ecurisë gjyqësore, nuk rezulton që zvarritja e hetimit të ketë sjellë ndonjë pasojë ligjore në drejtim të parashkrimit të ndjekjes penale, përkundrazi, çështja është dërguar për gjykim dhe ka përfunduar me shpalljen fajtor të personit të pandehur me vendim të formës së prerë. Organi procedues ka garantuar të gjitha të drejtat e palëve në proces për të siguruar mbrojtjen juridike apo të drejtën e ankimit.

51. Nga analizimi i akteve të administruara në fashikullin e Komisionit gjatë hetimit administrativ, dhe aktet e administruara në cilësinë e provës në Kolegj, trupi gjykues konstaton sa vijon.

51.1 Referuar të dhënave nga burimet arkivore, sipas raportit për vlerësimin e aftësisë profesionale⁴⁸ të subjektit të rivlerësimit, rezulton se mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasve I. e M. B. ndaj disa prokurorëve të Prokurorisë së Vlorës, ndër të cilët edhe prokurorja Flora Çela, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier procedimi penal nr. {***}, datë 18.09.2017, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”. Pas kërkesës së prokurorisë për pushimin e këtij procedimi penal, Gjykata e Shkallës së Parë Fier, me vendimin nr. {***}, datë 02.07.2018, ka vendosur rrëzimin e saj dhe vazhdimin e hetimeve. Më tej, ky procedim penal është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe është ende në fazë hetimi.

51.2 Bazuar në informacionin e mësipërm, Komisioni, me njoftimin e rezultateve të hetimit, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime⁴⁹ lidhur me këtë çështje. Në përgjigjet e

⁴⁶ Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një sërë aktesh dhe komunikimesh të Prokurorit të Përgjithshëm, që i përkasin vitit 2020, mbi masat procedurale parandaluese në kuadër të Covid-19, cituar në poshtëshënimin nr.13 të këtij vendimi.

⁴⁷ Në mbështetje të këtyre pretendimeve subjekti i rivlerësimit ka paraqitur katër urdhra të Prokurorisë së Vlorës që i përkasin përkatësisht viteve 2017, 2022, 2023 dhe 2024, lidhur me krijimin apo riorganizimin e seksioneve në këtë prokurori; tri urdhra të Prokurorit të Përgjithshëm të vitit 2018, për ndërprerje komandimi dhe caktim në pozicion të përkohshëm të tri prokurorëve; vendime të KLP-së të viteve 2019, 2020 dhe 2021 për dhënie lelesh të papaguara, caktime të përkohshme të prokurorëve apo komandime magjistrati, si dhe vërtetim të Prokurorisë së Vlorës mbi organikën e miratuar dhe numrin e prokurorëve faktikë të kësaj prokurorie për vitet 2019-2023, etj., cituar në poshtëshënimin nr. 13 të këtij vendimi.

⁴⁸ Pjesa III, faqe 20 e raportit për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

⁴⁹ i) shpjegime mbi çështjen e ankuar nga shtetasit I. e M. B.; ii) dokumentimin e veprimeve hetimore të kryera për këtë çështje nga subjekti; iii) dokumentimin e vendimit të dhënë ndaj ankesës/materialit kallëzues të shtetasve B.; iv) qartësimin dhe dokumentimin e statusit aktual të vendimit të dhënë mbi materialin kallëzues të shtetasve B. (nëse ka pasur ankim ndaj vendimit të organit të akuzës dhe si ka vijuar çështja në organet e gjyqësorit); v) të depozitohet kopje të vendimit nr. {***}, datë 02.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; si dhe vi) shpjegime mbi statusin aktual të çështjes së kthyer pas vendimit nr. {***}, datë 02.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

tij mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, ka dhënë shpjegime mbi veprimet procedurale të kryera prej saj në trajtimin e kallëzimit penal të shtetasës I. B. ndaj shtetasit K. U., duke vendosur fillimisht mosfillimin e procedimit penal dhe, pas urdhërimit të Gjykatës së Apelit për vazhdimin e hetimeve, regjistrimin e procedimit penal nr. {***}/2018, si dhe veprimet hetimore të kryera deri në kërkimin e saj për deklarimin fajtor të shtetasit K. U. për veprën penale të “Ndërtimi i paligjshëm”, për të cilën edhe u deklarua fajtor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin e datës 16.05.2023, duke i shoqëruar këto shpjegime me akte nga dosja e procedimit penal nr. {***}/2018.

51.3 Nga aktet e fashikullit të procedimit penal nr. {***}/2018, të administruar në Kolegj në cilësinë e provës, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se:

51.3.1 Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, është regjistruar materiali kallëzues nr. {***}, datë 04.09.2017, mbi bazën e materialeve procedurale që bëjnë fjalë për kallëzimin e shtetasës I. B. për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a-1 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit K. U., përcjellë nga Drejtoria e Policisë Vlorë, sipas së cilave⁵⁰: *Në datën 09.08.2017 jemi njoftuar për një ndërtim pa leje në Dhërmi. Është shkuar me grupin hetimor dhe në vendin e ngjarjes kemi konstatuar se është një objekt me dy kate me material dërrase [...] Objekti nuk ka të vendosur as dyer dhe as dritare. [...] Ka ardhur në Komisariatit e Policisë Himarë shtetasja I. B. [...], e cila në kallëzimin e saj sqaron se në pronën me toponim {***} e cila ndodhet në Dhërmi, gjykata ka vendosur sigurim padije që të mos bëhen transaksione derisa të mbarojë gjykimi civil. Vendimi i gjykatës nuk është respektuar. Sot prona është e pushtuar pa leje. Ka shkuar në pronë se është bërë ndërtim pa leje, një godinë me dërrasa. [...] në deklarimin e saj që ka dijani I. sqaron se disponoj urdhër vendosje sekuestro konservative dt. 20.06.2015, vendim gjykate datë 04.06.2015, vendim gjykate datë 27.07.2016, deklaratë noteriale nr. {***}, datë 11.02.2016, aplikim datë 11.02.2016, vërtetim hipotekor nr. {***}, datë 01.06.2015, vërtetim hipotekor nr. {***}, datë 01.06.2015. Për sipërfaqen e tokës 22.000 m² ajo disponon një vërtetim hipotekor certifikatë të pronësisë në emër të S. B. të cilën, sipas saj, nuk e ka për momentin. Në lidhje me dokumentacionin që ajo disponon nga ana jonë janë marrë me procesverbal këqyrje-marrje dokumentet e sipërpërmendura. [...] Në deklarimin e tij që ka dijani shtetasi K. K. sqaron se është punëtor në një beach-bar në afërsi të objektit në fjalë. Pronari i këtij objekti shtetasi K. U., nuk ndodhet këtu momentalisht dhe ai i ka lënë atij disa dokumente në lidhje me këtë objekt si dhe licencën e marrë nga Bashkia Himarë në lidhje me plazhin. Nga ana jonë janë marrë me këqyrje dokumentet e poseduara nga K. të cilat janë certifikatë pronësie e tokës ku është ndërtuar ky objekt, një leje nga Bashkia Himarë në lidhje me çadrat e plazhit si dhe një kontratë qiraje për sezonin e verës. Nisur nga këto rrethana është bërë shpallja në kërkim policor e shtetasit K. U. pasi nuk kemi pasur mundësi kontakti me të dhe për mungesë të dokumentacionit përkatës në lidhje me këtë ndërtim. [...].*

51.3.2 Lidhur me këtë material kallëzues, më datë 13.09.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se: *Nga studimi i materialit kallëzues nuk konstatoj elementë të veprës penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Rezulton se shtetasi është i pajisur me një kontratë qiraje për përdorimin dhe shfrytëzimin e pronës të marrë nga njësia vendore sipas një plani të caktuar, referuar kjo*

⁵⁰ Sipas informacionit për referimin e veprës penale të datës 29.08.2017 të Oficerit të Policisë Gjyqësore.

VKM-së nr. 369, datë 18.05.2016. Po kështu, objekti nuk plotëson kërkesat e ligjit penal për t'u klasifikuar veprimet e subjektit përdorues apo investues, sipas nenit 199/a të Kodit Penal. Qëllimi i këtij objekti nuk është ai i kërkuar nga neni 199/a i Kodit Penal, por në kuadër të përdorimit dhe shfrytëzimit të sipërfaqes së plazhit sipas kërkesave të kontratës dhe planit të biznesit miratuar nga njësitë vendore. Në lidhje me pretendimet për çështjen e pronësisë, kjo shtetase duhet t'i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e konfliktit në rrugë civile. Në këto rrethana, duke qenë se nuk konstatohet elementë të ndonjë veprë penale tjetër, ky material duhet të mosfillohet.

51.3.3 Pas ankimit të shtetases I. B. ndaj këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 31.10.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të prokurorisë. Ndaj këtij vendimi është ushtruar sërish ankim, për të cilin, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 29.03.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës nr. {***}, datë 31.10.2017, prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal të datës 13.09.2017 dhe vazhdimin e hetimeve, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: [...] në rastin konkret duhet që nga ana e organit procedues të kryhen veprime të tjera të nevojshme hetimore për të vërtetuar faktet e ngritura në kallëzimin e kërkuar duke bërë një interpretim të drejtë të të gjitha akteve nënligjore që i janë vënë në dispozicion nga ana e ankueses. Kështu, prej saj pretendohet se ndërtimi i kryer nga shtetasi K. U. është i paligjshëm pasi bëhet në tokën në pronësi të M. B., ndërkohë që ky pretendim nuk është verifikuar nëse është i vërtetë ose jo nëpërmjet një akti ekspertimi topografik, fakt ky që do të detyronte prokurorinë të merrte në shqyrtim edhe vendimin për sigurimin e padisë. Gjithashtu, nuk rezulton të jetë verifikuar nëse disponon leje ndërtimi nga Bashkia Himarë shtetasi K. U. për kryerjen e ndërtimit, në kushtet kur nga ana e kallëzueses pretendohet se, kontrata është paraqitur e falsifikuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë më datë 28.06.2018, vendimin nr. {***}, datë 31.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të formës së prerë.

51.3.4 Në zbatim të vendimit të mësipërm të gjykatës, subjekti ka regjistruar më datë 02.07.2018, procedimin penal nr. {***} të vitit 2018, për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, me arsyetimin se: [...] Fakti penal i kallëzuar nga shtetasja I. B. lidhet me një punim të kryer nga shtetasi K. U. në {***}, Dhërmi, Himarë, ku sipas kallëzueses punimet janë pa leje ndërtimi dhe në tokën e saj. Me vendimin e Gjykatës së Apelit kërkohen të verifikohen kontrata e qerasë me Bashkinë Himarë, punimet nëse ky shtetas ka leje dhe nëse kryhen në tokën e kallëzueses përmes një akti ekspertimi topografik. Pas studimit të vendimit të gjykatës dhe urdhërimeve të saj, në respektim të Kodit të Procedurës Penale, ka të dhëna për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm” parashikuar nga neni 119/a i Kodit Penal.[...]. Po në datën 02.07.2018, Drejtuesi i Prokurorisë Vlorë ka vendosur bashkimin e procedimit penal nr. {***}/2018, me procedimin me nr. {***}/2018, regjistruar nga një tjetër prokuror mbi bazën e materialit kallëzues të shtetases I. B., për veprën penale të “Pushtimit të tokës” dhe vijimin e hetimeve nga subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela.

51.3.5 Pas regjistrimit të procedimit penal si më sipër, nga ana e subjektit të rivlerësimit janë kryer një sërë veprimesh hetimore⁵¹, ndërsa më datë 13.10.2020 është vendosur kryerja e

⁵¹ (i) më datë 02.07.2018 është kërkuar informacion nga Bashkia Himarë nëse kontrata me nr. {***} prot., datë 15.05.2017, është lëshuar nga ky institucion apo nëse janë kryer verifikime në territorin ku kryhen punime, si dhe për faktin nëse ka pasur ankesa/prendime nga shtetasja I. B. etj; Bashkia Himarë ka përcjellë informacionin e

ekspertimit teknik të ndërtimit brenda datës 10.11.2020, duke thirrur si ekspertë Y. M., F. H. dhe L. B., me qëllim sqarimin e rrethanave të faktit nëse punimet e kryera nga shtetasi K. U. janë kryer brenda pasurisë së blerë nga ky shtetas apo jashtë saj. Ky akt ekspertim është administruar në organin e prokurorisë më datë 10.05.2021.

51.3.6 Më datë 01.06.2021, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale emrin e personit nën hetim K. U., i dyshuar për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/4 i Kodit Penal duke arsyetuar se: *Në kuadër të sqarimit të pretendimeve të kallëzueses, si dhe në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata e Apelit, është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik topografik në lidhje me sipërfaqen e tokës në të cilën ndodhet ndërtimi prej druri i kryer nga shtetasi K. U., duke qenë se kallëzuesja ka pasur pretendime pronësie mbi pasuritë e regjistruara në emër të këtij shtetasi. Rezulton nga akti i ekspertimit topografik se objekti dykatësh prej druri është ndërtuar në pasurinë me nr. {***} regjistruar në emër të shtetasis K. U. dhe V. K., blerë sipas kontratës më sipër nga shtetasi S. D.. Gjithashtu rezulton se sipas ortofotove, fotografive ajrore, ky objekt nuk ka qenë ekzistues në vitin 2015, por është ndërtuar në vitin 2017. Pasi janë administruar aktet e provat përkatëse, rezulton e provuar se shtetasi K. U. ka konsumuar elementët e veprës penale të ndërtimit të paligjshëm të një objekti prej druri [...].*

51.3.7 Me vendimin e datës 21.04.2022, prokuroret E. A. dhe Flora Çela kanë vendosur bashkimin e procedimeve penale nr. {***} të vitit 2018, {***} të vitit 2019 dhe nr. {***} të vitit 2021 në një procedim penal të vetëm që mban numrin {***} të vitit 2018, për shkak të lidhjes që kishin me njëri-tjetrin, si në drejtim të identitetit të palëve, ashtu dhe vendin e ngjarjes, ndjekja e të cilit do të kryhet nga të dy prokuroret. Çështja është dërguar për gjykim më datë 28.08.2022 me të pandehur K. U. akuzuar për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a/3 i Kodit Penal. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 16.05.2023, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit K. U. për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 18.07.2023, pasi nuk u ankimua.

52. Nga analizimi i fakteve të parashtruara më lart, trupi gjykues, me konsideratë qëndrimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë⁵² mbi natyrën e veprimeve që mund të kryhen përpara se të vendoset për regjistrimin ose mosfillimin e një procedimi penal, vëren fillimisht se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer ndonjë verifikim në drejtim të pretendimeve të

*kërkuar më datë 16.07.2018; (ii) më datë 13.07.2018, janë marrë deklarinimet e shtetasis K. U.; (iii) më datë 18.07.2018, është këqyrur vendi i ngjarjes në fshatin Dhërmi; (iv) me kërkesën e datës 19.07.2018 i janë kërkuar Bashkisë Himarë një sërë aktesh, si: kopje e njëhësuar me origjinalin të kontratës nr. {***} prot., datë 15.05.2017, praktikës së miratimit të kërkesës së shtetasis K. U. për leje sezonale të hapësirës publike. Kjo përgjigje është depozituar nga Bashkia Himarë më datë 25.07.2018; (v) me kërkesat e datave 16.10.2018, 25.10.2018, 22.11.2018, 13.11.2018 dhe 06.12.2018 është kërkuar nga ZVRPP-ja Vlorë informacion mbi pasuritë e paluajtshme të shtetasis K. U.. ZVRPP-ja Vlorë ka kthyer përgjigje me shkresat e datave 05.03.2019 dhe 15.07.2019; (vi) më datë 22.05.2019 janë këqyrur dhe janë marrë akte nga procedimi penal nr. {***}/2018; (vii) më datë 07.06.2019 janë marrë të dhëna nga shtetasi K. U.; (viii) më datë 12.06.2019 është kërkuar informacion shtesë nga Bashkia Himarë, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën e datës 01.07.2019; (ix) më datë 06.10.2020 është vendosur këqyrja dhe marrja e një kopje të regjistrit të hartës kadastrale.*

⁵² Në vendimin unifikues nr. 2, datë 20.06.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë theksohet se: “Rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi. Veprimet verifikuese duhen kryer në drejtim të verifikimit të shkaqeve të mosfillimit, por jo të hetimit me themel të ekzistencës të faktit penal dhe të zbulimit të fakteve lidhur me themelin e fajësisë apo të pafajësisë”.

kallëzueses se për pronën mbi të cilën po ndërtohej kishte një vendim gjykate për sigurim padie, dhe se kjo pronë ishte në emër të S. B., apo në drejtim të marrëdhënies së shtetasit K. U. me ndërtimin në fjalë. Si pasojë e mungesës së këtyre verifikimeve në drejtim të veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a-1, sikurse referohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, në vlerësimin e trupit gjykues edhe vendimi për mosfillimin e procedimit penal rezultoi i arsyetuar jo mjaftueshëm dhe qartë në drejtim të ekzistencës ose jo të elementëve të kësaj vepre penale. Mungesa e veprimeve verifikuese është konfirmuar edhe nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 29.03.2018, e cila prishi vendimin për mosfillimin e procedimit penal dhe urdhëroi organin e prokurorisë për vazhdimin e hetimeve duke caktuar detyra konkrete, ndër të cilat edhe kryerjen e një akti ekspertimi topografik. Në zbatim të këtyre urdhërimeve të gjykatës, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal në datën 02.07.2018, pra, pas më shumë se 3 muajsh nga vendimi i Gjykatës së Apelit, dhe ka marrë vendim për kryerjen e aktit të ekspertimit në datën 13.10.2020, pra, pas 2 vite e 3 muajsh nga momenti i regjistrimit të tij. Në analizë të shkaqeve që kanë sjellë këtë vonesë, trupi gjykues vlerëson se, fakti që vendimi i formës së prerë të gjykatës së shkallës së parë i është njoftuar organit të prokurorisë në datën 28.06.2018, si dhe fakti që procedimi penal është regjistruar pa emër personi në regjistrin e njoftimit të veprave penale, moment që do të kushtëzonte shtrirjen e veprimeve hetimore në një afat të caktuar, sipas parashikimeve të nenit 323, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, nuk përbëjnë rrethana që mund të përligjin marrjen e vendimit për kryerjen e ekspertimit ndërtimit (në datën 13.10.2020) pas 2 vite e 3 muajsh, pra, tej një afati të arsyeshëm dhe të pajustificuar në kushtet e një veprimtarie hetimore të një natyre jo të vështirë apo komplekse. Kjo vonesë në kryerjen e një ndër detyrave kryesore të caktuara nga gjykata nuk justifikohet as për shkak të masave kufizuese në organin e prokurorisë që nisën në muajin mars të vitit 2020, pra, pas rreth 1 viti e 8 muajsh nga regjistrimi i procedimit penal, si pasojë e situatës së pandemisë Covid-19, të cilat, referuar akteve normative të Këshillit të Ministrave⁵³ dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm⁵⁴, në fazën e hetimeve paraprake kufizonin kryerjen e veprimeve hetimore që lidheshin kryesisht me marrjen e deklarimeve të personave, e as për shkak të situatave që lidhen me transferimet/lëvizje të prokurorëve në organin e prokurorisë, që ndonëse duken evidente në rastin konkret, ato nuk mund të afektojnë në mënyrë cilësore veprimtarinë e prokurorit, për më tepër, që nuk rezultoi ndonjë akt (memo/relacion) i subjektit të rivlerësimit drejtuar titullarit të prokurorisë, në të cilin t’i jetë bërë me dije shqetësimi mbi ngarkesën e saj, e cila do të sillte, për rrjedhojë, pamundësi apo vonesa në kryerjen e hetimeve. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të ndërmarrë veprimet e nevojshme verifikuese përpara se të konkludonte se nuk ekzistojnë rrethanat për regjistrimin e procedimit penal, sipas parashikimit të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, kryerja e të cilave çoi më

⁵³ Akt normativ nr. 3, datë 15.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”; VKM-ja nr. 243, datë 24.03.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”; akt normativ nr. 9, datë 25.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; akt normativ nr. 21, datë 27.05.2020, “Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 9, datë 25.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”.

⁵⁴ Udhëzim i Përgjithshëm nr. 3, datë 19.03.2020, “Për disa masa procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, në funksion të parandalimit të përhapjes Covid-19”; udhëzim i përgjithshëm nr. 04, datë 24.03.2020, “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga Covid-19”; udhëzim nr. 6, datë 27.04.2020, “Për masat procedurale dhe administrative në veprimtarinë funksionale në mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga Covid-19”.

pas drejt kërkimit për deklarimin fajtor të të kallëzuarit dhe ka vepruar me vonesë të pajustificuar në zbatimin e detyrave të caktuara nga autoriteti gjyqësor.

53. *Lidhur me kallëzimin penal nr. {***}, datë 27.07.2021, të adresuar nga denoncuesja M. Ç., Komisionerja Publike, në ankim, sikurse Komisioni⁵⁵, ka konstatuar se: *Vendimi i mosfillimit, edhe në konsideratë të shpjegimeve të subjektit për ekzistencën e muajit gusht si kohë e kryerjes së pushimeve vjetore*, është marrë në tejkalim të afatit 15-ditor, sikurse parashikohet në nenin 291/1 të Kodit të Procedurës Penale. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj.*
54. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të konstatimit të mësipërm, pretendoi se vlerësimi i këtij materiali ka ndodhur gjatë periudhës së lejes së zakonshme të muajit gusht, dhe se nga ana e saj është shfrytëzuar e drejta që ka prokurori për zëvendësimin e ditëve të gatishmërisë. Në kushtet që nuk rezulton asnjë element mosveprimi, neglizhence apo shkelje e rregullave procedurale apo etike në përputhje me vendimin unifikues nr. 2/2013, si dhe në mungesë të ndonjë pasojë konkrete ose pretendimi procedural të cenuar, në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, tejkalimi i afatit nuk mund të interpretohet si shkelje që cenon parimin e besimit të publikut, aq më tepër në kushtet kur rasti përbën një situatë të izoluar dhe nuk karakterizon një sjellje sistematike nga subjekti i rivlerësimit.
55. Nga analizimi i akteve të administruara në fashikullin e Komisionit gjatë hetimit administrativ, dhe aktet e administruara në cilësinë e provës në Kolegj, trupi gjykues konstaton sa vijon.

55.1 Lidhur me denoncimin e adresuar në Komision nga shtetasja M. Ç.⁵⁶, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit⁵⁷, ka dhënë përgjithësisht të njëjtat shpjegime si në ankim, duke i shoqëruar këto shpjegime me akte nga dosja e fashikullit të kallëzimit penal nr. {***}, datë 27.07.2021, si dhe shkresën nr. {***} prot., datë 02.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, sipas së cilës nuk rezulton që pranë kësaj gjykate të jetë regjistruar ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. {***}/2021, nga shtetasja M. Ç..

55.2 Nga aktet e fashikullit të kallëzimit penal nr. {***}, datë 27.07.2021, të administruar edhe në Kolegj në cilësinë e provës, rezulton se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është regjistruar materiali kallëzues nr. {***}, datë 27.07.2021, mbi bazën e kallëzimit të shtetasës M. Ç., e cila ka kallëzuar shtetaset E. L. dhe M. Z., të cilat me veprime të kundërligjshme kanë ndikuar në ndryshimin e rezultatit lidhur me vlerësimin e doktoraturës së shtetasës M. Z.. Në lidhje me këtë kallëzim penal, subjekti i rivlerësimit ka vendosur në datën 04.10.2021 mosfillimin e procedimit penal dhe komunikimin e tij të interesuarve, të cilët mund të bëjnë ankim brenda afateve ligjore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: *“Nga studimi i këtij materiali kallëzues nuk konstatoj elementë të ndonjë vepr penale. Në lidhje me pretendimet e kallëzueses për ngjashmëri të dizertacionit, rezulton nga shkresa zyrtare kthim përgjigje e Universitetit se ngjashmëria është brenda normave të*

⁵⁵ Shih paragrafin 46.1.6 në faqen 49 të vendimit.

⁵⁶ Denoncimi i regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 25.10.2021. Në këtë denoncim shkelja ligjore referohet “Vendimi i Flora Çela në Prokurorinë Vlorë për mosfillimin e kallëzimit penal nr. {***}, datë 15.10.2021”.

⁵⁷ Në rezultatet e hetimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit: të japë shpjegime në lidhje me këtë denoncim, të depozitojë kopje të vendimit për mosfillimin e çështjes, si dhe të qartësojë e dokumentojë statusin ligjor të vendimit të mosfillimit të kësaj çështje deri aktualisht.

pranueshme dhe rezulton të jetë 5.99%. Në lidhje me pretendimet për shpërdorim detyre, për shkak të ndërhyrjes në të dhënat kompjuterike në lidhje me konkluzionin e ngjashmërisë së dizertacionit, rezulton se ky vendim është marrë nga disa pedagogë dhe jo nga e kallëzuara personalisht, për të krijuar dyshime të arsyeshme. Gjithashtu, në lidhje me pretendimet e saj, kallëzuesja duhet t'i drejtohet Ministrisë së Arsimit, për vlerësimin përkatës të pretendimeve të saj dhe mënyrës së përlllogaritjes së përqindjes së ngjashmërisë, nëse ndodhemi para rastit të plagjiaturës, apo botimit të veprës së tjetrit, duke mos respektuar të drejtën e autorit. Fillimisht ankesat duhet të jenë në rrugë institucionale për përcaktimin e këtyre të drejtave e më pas të ngrihen dyshime mbi elementë të tillë si shpërdorimi i detyrës”. Ky vendim i është dërguar shtetasës M. Ç. nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me shkresën nr. {***} prot., datë 15.10.2021.

56. Nga aktet e sipër referuara, trupit gjykues i rezulton se vendimi për mosfillimin e procedimit penal i datës 04.10.2021 është marrë në tejkallim të afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 291, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale⁵⁸, nga data e regjistrimit të kallëzimit penal me nr. {***}, datë 27.07.2021. Ndonëse argumentet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të periudhës së lejes në muajin gusht dhe kthimin e saj në detyrë pas zëvendësimit të ditëve të gatishmërisë nuk justifikojnë mosveprimin e saj në kohë, trupi gjykues mban në konsideratë faktin që shtetasja M. Ç. nuk rezulton të ketë ushtruar ankim në gjykatë ndaj kësaj vendimmarrjeje, megjithëse kjo vendimmarrje i është njoftuar nga organi i prokurorisë dhe ajo ka marrë dijeni lidhur me të⁵⁹.
57. **Lidhur me procedimin penal nr. {***}/2018 të adresuar nga denoncuesi V. H.,** Komisionerja Publike, në ankim, sikurse Komisioni⁶⁰, ka konstatuar se: (a) është vënë në lëvizje në intervale të gjata kohore për marrjen e akteve, duke proceduar në tejkallim të afateve kohore të arsyeshme; (b) ka marrë vendim thuajse pas tre muajve nga nisja e rihetimit datë 04.03.2021, më datë 31.05.2021 (njoftuar denoncuesit më 10.06.2021), për bërjen e aktit të ekspertimit, duke mos ndërmarrë në kohë veprimin e lënë nga gjykata. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj.
58. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të konstatimeve të mësipërme, ka pretenduar se në mungesë të shkeljeve procedurale, kur hetimi është zhvilluar në mënyrë të shteruar dhe të dokumentuar, si dhe pa pasoja në drejtim të parashkrimit të ndjekjes penale apo dështimit të akuzës, pretendimet e Komisioneres Publike nuk mund të shërbejnë si bazë për penalizim disiplinor të subjektit të rivlerësimit. Sipas saj, argumenti i Komisioneres se vendimi për ekspertimin është marrë pas dy vitesh nga vendimi i apelit, është argument i pabazuar në fakte. Në mbështetje të këtij pretendimi subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar fillimisht se vendimi nr. {***}, datë 09.04.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë, i formës së prerë, i është dërguar organit të prokurorisë me shkresën e datës 24.10.2019 dhe është administruar në protokollin e tij, por nuk është njoftuar/administruar formalisht prokurori i çështjes. Më tej, shpjegohet se pas njoftimit nga vetë kallëzuesi më datë 20.02.2020, prokurori është investuar proceduralisht duke

⁵⁸ Ky nen, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, parashikon se: “1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit”.

⁵⁹ Denoncuesja M. Ç., në denoncimin e saj të adresuar pranë institucionit të Komisionerëve Publikë, regjistruar në këtë institucion me nr. {***} prot., datë 19.10.2021, ka cituar shkresën e Prokurorisë Vlorë me nr. {***} prot., datë 15.10.2021, përmes së cilës i është përcjellë vendimi për mosfillimin e procedimit penal.

⁶⁰ Shih paragrafët 46.2.11 dhe 46.2.12 të vendimit.

kërkuar zyrtarisht kthimin e akteve të procedimit penal, ndërkohë që sipas shkresës së gjykatës nr. {***} prot., datë 04.03.2020, rezulton se aktet në dosjen gjyqësore nr. {***}, datë 13.02.2019, janë fotokopje dhe ndaj nuk është bërë kthimi i tyre. Lidhur me aktin e ekspertimit të datës 05.07.2021, subjekti ka shpjeguar se nga ky akt rezultoi qartazi se nuk kishte ndonjë ndërtim pa leje dhe se kallëzuesi kishte rrugë kalimi, çka përjashtonte përmbushjen e elementëve të veprës penale të “Vetëgjyqësisë”. Subjekti ka theksuar, gjithashtu, se në kohëzgjatjen e hetimit të kësaj çështjeje, në harkun kohor mars 2020 (kur është rifilluar) - korrik 2021, duhet mbajtur parasysh edhe pandemia globale Covid-19, e cila, sipas saj, përbën shkak objektiv të justifikueshëm⁶¹, për vonesat e mundshme në vijimin e veprimeve hetimore, ndërkohë që evidentohet edhe fakti se në vitin 2020 ajo ka trajtuar një numër prej 377 materialesh hetimore dhe ka mbartur vetëm 75 prej tyre, ndërsa në vitin 2021 ka trajtuar 452 materiale hetimore, mosfillime, pushime, kërkesa gjykimi, pezullime, etj., fakte që sipas saj dëshmojnë përkushtim konstant dhe cilësi në ushtrimin e detyrës.

59. Trupi gjyqësor, nga analizimi i akteve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2018, të adresuar nga denoncuesi V. H.⁶², të përcjellë në Komision nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë⁶³, si dhe aktet e administruara në Kolegj, konstaton sa vijon.

59.1 Më datë 17.07.2018, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***} për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, mbi bazën e materialeve procedurale të dërguara nga Komisioni i Policisë Himarë, për këtë veprë penale, në ngarkim të shtetasit N. M., pas kallëzimit të shtetasit V. H.. Në këtë urdhër parashtrihen rrethanat si vijojnë: *Në datën 30.06.2018 është marrë njoftim nga salla operative se në Dhërm, tek Hotel “{***}” ka një konflikt të shkaktuar për shkak të një bllokimi rruge kalimi. Pasi është shkuar në vendin e ngjarjes është konstatuar një furgon me targa {***}, në pronësi të firmës “{***}” i cili kishte bllokuar hyrjen për në kompleks. Është marrë kontakt me shtetasin V. H., i cili ka sqaruar se nuk lejohej të hynte në hyrjen e objektit. Në lidhje me këtë pretendim të kallëzuesit, shtetasi N. M. ka sqaruar se ai është pronari i parkimit dhe se shtetasi V. H., nuk mund të hyjë në portën e hotelit privat që ai posedon, pasi banorët e tjerë kanë hyrje tjetër për në objektet e tyre.*

59.2 Më datë 12.10.2018, subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendim për pushimin e këtij procedimi penal për veprën penale të “Vetëgjyqësisë”, duke argumentuar, ndër të tjera, se: *Nga analizimi i akteve nuk përcaktohet qartë cilat janë të drejtat e palëve mbi truallin, parkimin dhe pjesët takuese të tyre, për shkak se secila palë pretendon një të drejtë të njohur në kontratën e sipërmarrjes. Duke qenë se janë të dyja të drejta të pretenduara, që kërkohet të ushtrohen nga të dyja palët, ato duhet t'i drejtohen gjykatës mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes, për bashkëpronësinë dhe pjesën e tyre takuese, si dhe pretendimet mbi servitutin e papërcaktuar në kontratë si rrugë kalimi në rast se nuk ka rrugë tjetër kalimi. Në këto rrethana, duke qenë*

⁶¹ Subjekti i rivlerësimit ka cituar nenin 74, pika 1 të ligjit nr. 96/2016, sipas së cilit: “1. Me anë të kriterit të aftësisë organizative vlerësohet aftësia e magjistratit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit”.

⁶² Denoncim i regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 28.12.2022, i përcjellë nga Kolegji me shkresën nr. {***} prot., datë 27.12.2022; denoncim nr. {***} prot., datë 11.08.2021; denoncim nr. {***} prot., datë 11.08.2021.

⁶³ Përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 21.06.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

se konflikti ka natyrë juridiko – civile, palët duhet t'i drejtohen gjykatës sipas kontratës së sipërmarrjes, e cila do të përcaktojë të drejtat e tyre reale mbi truallin.

59.3 Pas ankimit të vendimit të mësipërm nga ana e kallëzuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 13.02.2019⁶⁴, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij dhe lënien në fuqi të vendimit të pushimit të prokurorisë. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar sërish ankim kallëzuesi, për të cilin Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 09.04.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 13.02.2019, prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2018 dhe kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve organit të prokurorisë. Në këtë vendim, gjykata, ndër të tjera, arsyeton se: *[...] duhej që organi procedues të kryente një hetim më të plotë, duke kryer edhe veprime të tjera procedurale duke përfshirë këtu edhe kryerjen e një akti ekspertimi topografik dhe inxhinier ndërtimi për ti dhënë përgjigje problematikave që përmban ky konflikt dhe për të përcaktuar nëse në kompleksin e ndërtuar nga shoqëria “{***}” ka rrugë tjetër nga ku makinat të mund të hyjnë në kompleks, nëse kjo rrugë është pronë private e shtetasit N. M., apo ajo është krijuar për shfrytëzim të përbashkët nga të gjithë banorët e kompleksit. Duhet të përcaktohet nëse hyrja për në parkimin e kompleksit është kryer në përputhje me projektin e miratuar nga KRRR e Bashkisë Himarë. Gjithashtu, nga prokuroria duhet të merren në pyetje dhe banorë të tjerë të kompleksit për të konfirmuar nëse veprimet e shtetasit N. M. drejtohen ndaj të gjithë banorëve apo është një konflikt vetëm me ankuesin V. H.. [...].*

59.4 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.02.2020, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që në kuadër të zbatimit të vendimit nr. {***}, datë 09.04.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë, dërgimin e akteve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2018. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2020, ka informuar organin e prokurorisë se *nga verifikimi i kryer rezulton se në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. {***}, datë 13.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, aktet e administruar janë fotokopje të procedimit penal nr. {***}/2018, të dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. {***} prot., datë 06.02.2019.*

59.5 Me vendim të datës 04.03.2021, Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur bashkimin e procedimit penal nr. {***}/2018, që hetohet nga prokurore Flora Çela, me procedimin penal me nr. {***}/2019⁶⁵, i cili është në hetim nga prokurori A. S., pasi në të dyja këto procedime penale bëhet fjalë për të njëjtin person të dyshuar dhe për të njëjtën vepër penale. Ky vendim merr numrin {***}/2018 dhe me hetimin e tij ngarkohet prokurore Flora Çela.

59.6 Në zbatim të vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit ka vendosur më datë 31.05.2021 kryerjen e ekspertimit teknik të ndërtimit, i cili duhet të kryhet deri më datë 10.07.2021, duke i dhënë përgjigje pyetjeve: *- Në kompleksin e ndërtuar nga firma “{***}” a ka rrugë tjetër nga ku mund të hyjnë në kompleks. Kjo rrugë e pretenduar është pronë private e shtetasit N. M. apo është krijuar për shfrytëzim të përbashkët nga të gjithë banorët e kompleksit. Hyrja për në kompleks a është në përputhje me projektin e miratuar nga*

⁶⁴ Në aktet vijuese ky vendim gjykate referohet me nr. {***}, datë 13.02.2019.

⁶⁵ Ky procedim penal është regjistruar nga prokurori A. S. me urdhrin e datës 30.07.2019, për veprën penale të “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199 mbi bazën e kallëzimit të shtetasit V. H..

KRRT Bashkia Himarë. Ky akt ekspertim është administruar në organin e prokurorisë më datë 05.07.2021.

59.7 Më datë 29.07.2021, subjekti i ka kërkuar sërish Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2018, për veprat penale të “Vetëgjyqësisë” dhe “Ndërtimit të paligjshëm”, parashikuar nga nenet 277 dhe 199/a të Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin {***}, datë 25.07.2022, ka vendosur: *“Mosmiratimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2018; kthimin e akteve prokurorisë për të formuluar akuzën “Ndërtim i paligjshëm” dhe “Vetëgjyqësia”. Veprimet hetimore të kryhen brenda një afati një mujor”*. Ndaj këtij vendimi, ka ushtruar ankim, më datë 19.09.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, prokurorja Flora Çela, duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 25.07.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 03.11.2022⁶⁶, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. {***}, datë 25.07.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me të njëjtin trup gjykues”, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: [...] në vendimin e gjykatës nuk është dhënë asnjë disponim lidhur me veprimtarinë hetimore të kryer nga organi hetimor ndaj të cilit prokurori ka realizuar hetime për veprën penale në gjithë procedimin. Mungesa e disponimit për këtë pjesë të hetimit, e bën vendimin e metë, pasi gjykata nuk ka argumentuar detyrat që i ka lënë organit hetimor, por ka kërkuar prej saj formulimin e akuzës, duke krijuar paqartësi dhe për vetë organin procedurës, për nevojën e kryerjes së këtyre veprimeve hetimore dhe përfundimin që kërkohet të arrihet përmes tyre”*. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.06.2023, ka informuar prokuroren Flora Çela se dosja penale që i përket kallëzuesit V. H., me objekt “Kërkesë për pushim të procedimit penal nr. {***}/2018, me nr. {***} vendimi, datë 05.12.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ndodhet në Gjykatën e Apelit”.

60. Në përfundim të hetimit administrativ, me prapësimet mbi rezultatet e hetimit⁶⁷, subjekti ka dhënë shpjegime mbi aspektet procedurale të regjistrimit të procedimit penal pas urdhërimit të gjykatës për vazhdimin e hetimeve lidhur me kallëzimin e shtetasit V. H., dhe detyrat e kryera në zbatim të këtij vendimi, duke paraqitur, ndër të tjera, edhe shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 04.10.2023, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, përmes të cilës informohet se: *“Në përgjigje të kërkesës tuaj, lidhur me datën e dërgimit të formës së prerë të vendimit nr. {***}, datë 13.02.2019, ju bëjmë më dije: Rezulton se për vendimin penal me nr. {***}, datë 13.02.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, i cili i përket ankuesit V. H., është bërë nga sekretaria e gjykatës shënimi i formës së prerë në datën 23.10.2019. Me shkresën përcjellëse, datë 24.10.2019, është dërguar vendimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe vendim nr. {***} (korrigjuar në nr. {***}), datë 13.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”*.

⁶⁶ Ky vendim është depozituar nga denoncuesi.

⁶⁷ Komisioni, i ka kaluar subjektit barrën e provës: *“Duket se subjekti në kthimin e çështjes për hetime të tjera, nuk ka përmbushur detyrën e lënë nga gjykata e Apelit Vlorë për të pyetur banorët e tjerë të godinës, pasi në dosje nuk ka të administruar ndonjë akt që të provojë këtë fakt. -- Duket se kryerja e hetimeve pas vendimit të gjykatës së Apelit Vlorë datë 09.04.2019 për kthimin e çështjes për hetime të tjera, ka zgjatur më shumë se 2 vjet deri në kërkesën për pushimin e çështjes datë 29.07.2021, në mënyrë të pajustificuar, pasi nga aktet nuk konstatohet kryerja e ndonjë veprimi hetimor; -- Nga aktet rezulton se detyra e lënë nga gjykata e Apelit për kryerjen e aktit të ekspertimit topografik është përmbushur në datë 31.05.2021, veprim hetimor ky i ndërmarrë dy vite pas vendimit të Gjykatës së Apelit”*. Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar subjektit të dokumentojë statusin ligjor të kësaj çështjeje.

61. Veç sa më lart, nga aktet e fashikullit të procedimit penal të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 31.01.2024, ka vendosur: “Kthimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, që i përkasin procedimit penal nr. {***/2018”, duke argumentuar, ndër të tjera, se: “Në kushtet kur Prokuroria është tërhequr nga kërkesa për pushimin e çështjes penale në kuadër të procedimit penal nr. {***} të vitit 2018, gjykata, në respektim të detyrimit kushtetues dhe ligjor, pa shqyrtuar themelin e çështjes, pranon kërkesën e prokurorit për kthimin e akteve të hetimit pasi gjykimi ka mbetur pa objekt, vendimi ka marrë formë të prerë pasi nuk u ankimua në datë 27.02.2025”.
62. Në konsideratë të rrethanave të përshkruara më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka nisur zbatimin e detyrave të caktuara nga Gjykata e Apelit Vlorë në vendimin e saj nr. {***}, datë 09.04.2019, me marrjen e vendimit për kryerjen e ekspertimit teknik të ndërtimit më datë 31.05.2021, pra, pas rreth 2 (dy) vitesh. Në analizë të shkaqeve që mund të kenë çuar në një vonesë të tillë, trupi gjykues vlerëson se fakti që shënimi i formës së prerë nga sekretaria e gjykatës mbi vendimin e gjykatës së shkallës së parë është bërë në datën 23.10.2019, si dhe pretendimi i subjektit se vendimi i formës së prerë i përcjellë organit të prokurorisë me shkresën e datës 24.10.2019 nuk i është njoftuar/administruar asaj formalisht, ndonëse i paprovuar, nuk përbëjnë rrethana që justifikojnë vonesën tej një afati të arsyeshëm në ndërmarrjen e këtij veprimi të lënë si detyrë nga gjykata. Gjithashtu, vënia në lëvizje e subjektit të rivlerësimit për kërkimin e kthimit të akteve të procedimit penal nga gjykata në datën 20.02.2020, pra, pothuajse pas 10 (dhjetë) muajsh nga data e vendimit të Gjykatës së Apelit apo pas 4 (katër) muajsh nga data e përcjelljes së vendimit të formës së prerë të gjykatës në organin e prokurorisë, edhe duke abstraguuar nga fakti se vendimi i formës së prerë, megjithëse i administruar në organin e prokurorisë, nuk i është njoftuar formalisht subjektit të rivlerësimit e, për më tepër, që aktet në dosjen gjyqësore ishin fotokopje dhe dosja origjinale e procedimit penal ndodhej në organin e prokurorisë, në vlerësimin e trupit gjykues, dëshmojnë sërish për vonesa në drejtim të përmbushjes së detyrave të caktuara nga gjykata. Trupi gjykues i gjen pa ndikim në vonesën e evidentuar në rastin konkret, masat kufizuese në kuadër të pandemisë globale Covid-19 apo ngarkesën e pretenduar të prokurores, pasi sikurse arsyetuar më lart, këto masa në fazën e hetimeve paraprake kufizonin kryerjen e veprimeve hetimore që lidheshin kryesisht me marrjen e deklarimeve të personave, ndërkohë që kryerja e këtij veprimi hetimor nuk kërkon një kohë të dedikuar, e cila do të kërkonte angazhim të shtuar të subjektit të rivlerësimit, të atillë që mund të ndikohej nga ngarkesa në punë e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se ngarkesa në punë, edhe pse në rastin konkret shifrat e raportuara nga subjekti i rivlerësimit nuk mbështeten në ndonjë akt zyrtar të organit të prokurorisë, nuk mund të afektojë në mënyrë cilësore veprimtarinë e prokurorit, dhe kryerjen me efektivitet të detyrave të tij.
63. ***Në lidhje me procedimin penal nr. {***}, datë 18.12.2019, të adresuar nga denoncuesja R. B., Komisionerja Publike, në ankim, ashtu si Komisioni⁶⁸, konstaton se: Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në drejtim të identifikimit të elementëve të veprës penale të vetëgjyqësisë, ashtu sikurse kishte konstatuar edhe gjykata mbi vendimet e subjektit, të cilat rezultuan të prishura dhe iu kthyen subjektit për kryerjen e veprimeve të mëtejshme***

⁶⁸ Shih paragrafin 46.3.9 dhe 46.3.10 të vendimit.

hetimore, në drejtim të kualifikimit të veprës penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj.

64. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar shkakun e ankimit, duke argumentuar se interpretimi i ndryshëm i organeve gjyqësore në lidhje me vendimmarrjen e prokurorit nuk përbën në vetvete shkak për penalizim disiplinor, aq më pak për aplikimin e masës ekstreme të shkarkimit nga detyra, dhe se vendimmarrja e saj ka qenë e motivuar në përputhje me standardet e ligjit procedural penal, çka përjashton çdo konkluzion se është cenuar besimi i publikut në ushtrimin e funksionit. Sipas subjektit të rivlerësimit, pushimi i çështjes është vendosur duke vlerësuar se mungojnë elementët e veprës penale të “Kanosjes” apo ndonjë vepre tjetër penale, dhe se konflikti është konsideruar si një mosmarrëveshje civile për shkak të bashkëpronësisë në ndërtesë, ndërsa për pretendimet që lidhen me “Fyerjen” është vlerësuar se palët mund t’i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës, sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Më tej, subjekti ka shpjeguar se ndaj vendimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2019 është ushtruar ankim nga kallëzuesja dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 05.12.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së saj, duke lënë në fuqi vendimin e prokurorit, dhe se çështja ndodhet ende në shqyrtim në shkallën e dytë dhe vendimi për ankimin e kallëzueses nuk ka marrë ende formë të prerë. Në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, periudha kohore ndërmjet regjistrimit të procedimit dhe marrjes së vendimit përfundimtar ka qenë rreth një vit e një muaj, çka nuk përbën në vetvete shkak për konstatimin e cenimit të besimit të publikut apo për vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, për arsyet si vijojnë: volumi i konsiderueshëm i punës me një total prej 452 materialesh hetimore të trajtuara gjatë vitit 2021, nga të cilat 64 janë dërguar për gjykim ndërsa 34 procedime penale kanë qenë më të arrestuar në flagrancë; hetimi nuk ka kaluar afatet ligjore të përcaktuara nga neni 323 i Kodit të Procedurës Penale; nuk janë kushtet e parashkrimit të ndjekjes penale të veprës objekt hetimi; vendimmarrja mbi këtë procedim është realizuar brenda një afati të arsyeshëm në ndikim të procesit të rivlerësimit kalimtar mbi ngarkesën e punës së prokurorëve dhe vakancave të krijuara; Gjykata e Apelit, në vendimin për kthimin e çështjes për hetime të mëtejshme, nuk ka përcaktuar afat kohor për përfundimin e tyre.
65. Trupi gjykues i Kolegjit, pas shqyrtimit të akteve në fashikujt e Komisionit dhe në aktet e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, konstaton si më poshtë.

65.1 Në denoncimin e adresuar në Komision nga denoncuesja R. B.⁶⁹, ngrihen pretendime për shpërdorim detyre për shkak të favorizimit të shtetasit A. M. (vëllai i një gjyqtari), për disa prokurorë, gjyqtarë e OPGj të Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndër të cilët edhe për subjektin Flora Çela, e për të cilët ka paraqitur njëherazi edhe kallëzim penal pranë Prokurorisë së Posaçme. Kjo e fundit ka kaluar aktet për shkak të moskompetencës lëndore e tokësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, e cila i ka përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, e cila ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

⁶⁹ Regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 21.10.2020.

65.2 Në përfundim të hetimit administrativ, me prapësimet mbi rezultatet e hetimit⁷⁰, subjekti i rivlerësimit, sikurse në ankim, ka dhënë shpjegime mbi ecurinë e shqyrtimit të procedimit penal dhe arsyetimin e vendimmarrjes së saj për pushimin e pushimin e çështjes, duke paraqitur akte nga dosja e procedimit penal nr. {***}, datë 18.12.2019.

65.3 Nga aktet e fashikullit të procedimit penal nr. {***}, datë 18.12.2019, të administruar në Kolegj në cilësinë e provës, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se:

65.3.1 Më datë 18.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, mbi bazën e materialit të referuar nga Komisariati i Policisë Vlorë⁷¹. Nga parashtrimi i rrethanave të faktit, sipas këtij urdhri, rezulton se: [...] në datën 27.11.2019 janë paraqitur në Komisarlatin e Policisë Vlorë, shtetaset R. B. dhe L. M., duke bërë ankim penal për fillimin e çështjes penale ndaj shtetasit A. M., për veprën penale të “Kanosjes”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Në ankimin e saj, shtetasja R. B. ka sqaruar se në datën 27.11.2019 rreth orës 15:40 ka qenë duke shkuar tek apartamenti i saj në lagjen “{***}” Vlorë, pallati “{***}”. Sapo ka shkuar tek hyrja i ka dalë para shtetasi A. M., i cili i ka zënë portën me krah. Ajo ka tentuar të hapë portën së bashku me shtetasen L. M., por janë shtyrë nga shtetasi A. M., duke u kërcënuar me fjalët “nuk do ta hash ti djersën time, nuk lejohet pasi është pronë private”. Në këto rrethana ato kanë njoftuar në telefon policinë. Po kështu, në ankimin e saj shtetasja L. M. ka deklaruar se në datën e mësipërme ka shkuar së bashku me shtetasen R. B., për tek pallati dhe u ka dalë para shtetasi A. M., dhe me shume sforco ato kanë arritur të hyjnë, duke u kërcënuar nga ky shtetas me fjalët “do ta shikoni çfarë do t’ju bëj.

65.3.2 Më datë 26.02.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, duke parashtruar se: I pyetur në lidhje me ngjarjen, shtetasi A. M. ka sqaruar se pallati në të cilën banon ankuesja është ndërtuar nga familjarët e tij dhe kjo shtetase nuk ka paguar detyrimet e ujësjellësit dhe ashensorit. Prej tij është kërkuar likuidimi i detyrimeve të pallatit dhe mospërdorimi i ashensorit për shkak të mospagimit të detyrimit të mirëmbajtjes. Më tej ka sqaruar se nuk i ka shtyrë apo kanosur këto shtetase, por prej tyre është kërcënuar me fjalët “Të ka ardhur fundi”. [...] Nga hetimet e këtij procedimi penal, konstatohet se ndërmjet palëve ka një konflikt të mëparshëm në lidhje me pretendimet e pronësisë mbi apartamentin në të cilin jeton shtetasja L. B., e cila e ka marrë prej shtetasit M. M. dhe objekti në të cilin ndodhet ky apartament është ndërtuar nga familjarë të shtetasit A. M.. [...] Nga deklaratimet e dhëna, nuk rezulton të ndodhemi para elementëve të veprës penale të kanosjes, pasi nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara nga ligji për ekzistencën e figurës së kësaj vepre penale. Kanosja duhet të jetë serioze, e çastit, e mundshme, reale dhe të mos lërë shkak për moskryerjen e saj, pra dëmin e jetës apo shëndetit. Në rastin konkret konflikti ka qenë në kuadër të debatit me fjalor fyes dhe tone të acaruar mes dy palëve, çka nuk përbëjnë element të veprës penale të “Kanosjes” parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Për fjalorin e

⁷⁰ Në rezultatet e hetimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime lidhur me: i) pozitën e saj në hetimin e kallëzimit të adresuar në prokurori nga denoncuesja, i hetuar e përfunduar prej saj, shkak i të cilës është bërë më tej edhe kallëzimi në SPAK, për shpërdorim detyre; ii) veprimet hetimore të kryera; iii) statusin aktual të kallëzimit të hetuar duke depozituar kopjen e vendimit të dhënë (nëse ka të tillë); iv) statusin aktual të çështjes nëse ajo është në hetim apo ka përfunduar në organet e gjyqësorit.

⁷¹ Informacion për referimin e veprës penale te prokurori; dy procesverbale ankimi të shtetaseve R. B. dhe L. M., procesverbale deklarimi të shtetasve R. B., L. M., A. M., dhe M. M.; procesverbal kallëzimi i shtetasit A. M.

*përdorur fyes, palët mund t'i drejtohen gjykatës sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, për të provuar akuzën për veprën penale të “Fyerjes” parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal. Për sa i përket pretendimit të shtetasit A. M. për hyrjen në banesë, nga shtetasja R. B. [...], mund t'i drejtohet gjykatës referuar nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, për veprën penale të “Dhunimit të banesës” parashikuar nga neni 112/1 i Kodit Penal, duke provuar më tej edhe pronësinë e objektit të pretenduar i cili posedohet nga shtetasja R. B.. Pas ankimit ndaj këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 13.10.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të pushimit.*

65.3.3 Kundër vendimit të mësipërm, ka paraqitur ankim kallëzuesja R. B., për të cilin, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 22.12.2020, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 13.10.2020, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, dhe kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve sipas veprimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese”. Në këtë vendim, ndër të tjera, arsyetohet se: “Gjykata e Apelit vlerëson se konkluzioni i prokurorisë se në veprimet e kryera nga shtetasi A. M. nuk gjenden element të figurave të veprave penale është i gabuar dhe rezultat i hetimit të paplotë. Gjykata e Apelit vlerëson se nga ana e prokurorisë nuk është hetuar dhe nuk i është kthyer përgjigje pretendimeve të kallëzueseve lidhur me veprën penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Kallëzueset kanë pretenduar se shtetasi A. M. nuk ka të drejta pronësie mbi pasurinë për të cilën janë në konflikt e megjithatë i kufizon në ushtrimin e së drejtës së gëzimit dhe posedimit, duke penguar hyrjen në të, për të dyja kallëzueset. Sipas tyre, i kallëzuari i pengon me pretendimin se nuk kanë shlyer detyrimet e bashkëpronësisë, por nuk rezulton ndonjë akt që ky shtetas të jetë administrator i pallatit ku ndodhet njësia e banimit. Gjykata e Apelit Vlorë vlerëson se ka qenë e nevojshme të hetohet edhe për veprën penale “Vetëgjyqësia” e parashikuar në nenin 277 të Kodit të Procedurës Penale, dhe në rast se pretendimet kanë qenë objekt i ndonjë hetimi tjetër, të administrohen aktet dhe të vlerësohen. [...] Gjithashtu, ka pretendime se kallëzueset nuk gëzojnë të drejta pronësie mbi njësinë e banimit dhe, për këtë shkak, janë zhveshur nga posedimi dhe janë penguar të hyjnë në të, nga ana e të kallëzuarit, pa një vendim gjyqësor. Pra, me veprimet e tij, shtetasi A. M. ka menduar të rivendosë të drejtën e tij të pretenduar të pronësisë, të cenuar sipas tij nga kallëzueset. [...] rezulton që nga prokuroria nuk është hetuar dhe nuk është përcaktuar nëse me veprimet e tij shtetasi A. M. ka qenë në kushtet e mbrojtjes së atë çastme, të lejuar nga neni 310 i Kodit Civil apo është përpjekur të rivendosë të drejtën e tij të posedimit, si pronar i pasurisë së paluajtshme pa iu drejtuar organeve gjyqësore [...]”.*

65.3.4 Në zbatim të vendimit të mësipërm të gjykatës, janë administruar aktet e procedimit penal nr. {***}/2019, dërguar për gjykim në datën 25.11.2020, me të pandehur shtetasin A. M., për veprën penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimeve të shtetasës R. B.. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 08.11.2021, ka vendosur deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A. M., për veprën penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, vendim jo i formës së prerë.

65.3.5 Në datën 13.04.2022, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, në të cilin arsyetohet: *“Në përfundim të hetimit, rezulton se janë administruar aktet e procedimit penal nr. {***}/2019 sipas të cilit janë vlerësuar veprimet e shtetasit A. M. në drejtim të apartamentit të pretenduar nga kallëzuesja R. B., dhe gjithashtu janë gjykuar në gjykatën e rrethit Gjyqësor Vlorë. Për të njëjtin pretendim mbi apartamentin prokuroria nuk*

*mund të kryejë hetime të tjera, pasi këto sjellje janë hetuar e gjykuar më parë dhe nuk kanë qenë objekt hetimi apo pretendimi në kallëzimin e datës 27.11.2019. Në këtë kallëzim ka qenë objekt hetimi kanosja e pretenduar nga kallëzuesja L. B. për të cilën Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka ngritur asnjë pretendim për vendimmarrjen e prokurorit. Sa më sipër, në rrethanat kur sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, pranë kësaj prokurorie janë hetuar dhe gjykuar sjelljet e shtetasit A. M. janë drejtim të vendosjes së të drejtave të tij mbi apartamentin e pretenduar nga shtetasja R. B., nga ana e organit të akuzës çmohet se ky procedim penal duhet të pushohet, pasi objekti i hetimit të saj ka qenë kanosje dhe nuk vend për hetim të ri ndaj elementëve të vetëgjyqësisë, kur kjo vepër është trajtuar më parë". Pas ankimit të shtetasës R. B. ndaj këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 05.12.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankueses. Me shkresën nr. {***} prot., datë 09.06.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ka informuar prokurorinë se ky vendim është ankimuar e aktualisht ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Apelit, e se nuk disponohet informacion lidhur me fazën e gjykimit pranë kësaj gjykate.*

66. Referuar përmbajtjes së urdhrin të regjistrimit të procedimit penal të datës 18.12.2019, trupit gjykues nuk i rezulton ndonjë arsytim lidhur me faktin nëse vepra penale e “Kanosjes” e parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal në këtë rast konkurren me veprën penale të “Vetëgjyqësisë”, e parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, sa kohë që nga shtetasi A. M., i cili kishte nisur konfliktin duke ndaluar kallëzuesen të hynte në pallat, pretendohet për të drejta mbi pasurinë e paluajtshme. Kjo mungesë analize ka çuar në mungesën e veprimtarisë së nevojshme hetimore në drejtim të marrëdhënies apo të drejtave të shtetasit A. M. në pallatin ku banonte kallëzuesja, veprime që mund të kishin çuar drejt elementëve të veprës penale të “Vetëgjyqësisë” të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Mungesa e veprimeve të plota hetimore është konfirmuar edhe nga kontrolli gjyqësor i Gjykatës së Apelit, e cila ka rikthyer çështjen në organin e prokurorisë për hetime të mëtejshme duke caktuar detyrë konkrete marrjen e akteve të procedimeve penale të tjera lidhur me këta shtetas, veprim që duhet të ishte kryer nga vetë subjekti i rivlerësimit sa kohë që në vendimin e saj për pushimin e çështjes penale evidentohet një konflikt i mëparshëm i këtyre shtetasve për çështje pronësie. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se arsytimi jo i plotë i vendimit të pushimit të procedimit penal të datës 26.02.2020, në drejtim të identifikimit të elementëve të veprës penale të “Vetëgjyqësisë”, ka çuar në moskryerjen e veprimtarisë së nevojshme hetimore, konfirmuar nga kontrolli gjyqësor i Gjykatës së Apelit. Ndërkaq argumentet e sjella nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të kohëzgjatjes së hetimeve të këtij procedimi penal apo ngarkesës së pretenduar gjatë hetimit të çështjes, konsiderohen jo relevante në drejtim të konstatimeve të evidentuara në ankim.
67. ***Në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2021 të adresuar nga denoncuesi M. M., Komisionerja Publike, në ankim, sikurse Komisioni⁷², ka vlerësuar se: Subjekti i rivlerësimit ka munguar të kryejë veprimet hetimore në kohë, sikurse ka disponuar me vendim për kryerje të aktit të ekspertimit për verifikim në terren të apartamenteve në datën 29.12.2021, pas tri muajve nga regjistrimi i procedimit penal datë 27.09.2021. Po ashtu, rezultoi se gjykata në dy raste, e ka kthyer vendimin e prokurorisë, për hetime të mëtejshme. Të njëjtin qëndrim, mbajti edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj.***

⁷² Shih paragrafët 46.5.11 - 46.5.13 të vendimit.

68. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të shkakut të ankimit, ka pretenduar se të gjitha veprimet janë realizuar në respekt të afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale dhe nuk konstatohet asnjë rrethanë që të përbëjë shkelje të rregullave procedurale apo të cenojë parimin e besimit të publikut në kuptim të nenit E të Aneksit të Kushtetutës. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar ecurinë e shqyrtimit të dy kallëzimeve penale të shtetasës O. O. ndaj shtetasit M. M., duke evidentuar, ndër të tjera, faktin se vendimi i formës së prerë nga gjykata është dërguar me shkresën e datës 19.11.2021, paraqitur si provë e re në Kolegj. Më tej, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vendimi për caktimin e aktit të ekspertimit është marrë me një diferencë kohore më pak se një muaj nga data e dorëzimit të dokumenteve të fundit nga ana e të pandehurit, dhe ky fakt lidhet me përfundimin e dorëzimit të dokumentacionit nga të dyja palët dhe konfirmimit të rrethanave faktike dhe civile të mosmarrëveshjes. Nga subjekti i rivlerësimit evidentohet edhe fakti se hetimi për këtë procedim penal është zhvilluar në harkun kohor 26.05.2021- 05.05.2022 kur është marrë vendimi për dërgimin e çështjes për gjykim brenda afateve kohore të arsyeshme. Në përfundim, çështja është pushuar me vendimin nr. {***}, datë 04.06.2024 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në zbatim të ligjit për amnistinë.
69. Trupi gjykues i Kolegjit, pas shqyrtimit të akteve në fashikujt e Komisionit, si dhe aktet e administruara në cilësinë e provës në Kolegj, konstaton se:

69.1 Komisioni, me qëllim verifikimin e pretendimeve të ngritura në denoncimin e adresuar nga denoncuesi M. M., ka administruar gjatë hetimit administrativ aktet e procedimit penal nr. {***}/2021, përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë⁷³, nga të cilat rezultoi se:

69.1.1 Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, janë regjistruar: (i) kallëzimi penal nr. {***} datë 25.11.2020, mbi bazën e materialeve procedurale të përcjella nga Komisariati i Policisë Vlorë⁷⁴, për veprën penale “Dhunim banese”, parashikuar nga neni 112 i Kodit Penal, përmes së cilit shtetasja O. O. ka kallëzuar vëllain e saj M. M. dhe motrën S. R., për shqyerjen e dyerve të apartamenteve që ajo disponon si pronare truall në pallatin e ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK, në lagjen “{***}”, Vlorë; (ii) kallëzimi penal nr. {***}, datë 08.01.2021, mbi bazën e materialeve procedurale⁷⁵ të përcjella nga Komisariati i Policisë Vlorë për veprat penale “Kanosja e gjyqtarit”, “Kanosja” dhe “Dhunimi i banesës”, parashikuar nga nenet 317, 84 dhe 112 të Kodit Penal, përmes së cilit shtetasja O. O. ka kallëzuar sërish të njëjtët shtetas për pushtimin e apartamenteve, për kanosje dhe intimidimin e avokatit të saj.

69.1.2 Me vendimin e datës 01.12.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, lidhur me materialin kallëzues nr. {***}, datë 25.11.2020, me arsyetimin se: *“Nga studimi i materialit, aktet e administruara nuk konstatoj element të ndonjë vepre penale pasi çështja ka natyrë juridiko-civile. Pavarësisht kësaj, duke qenë se nuk paraqitet dëmtimi banesës sipas këqyrjes së vendit të ngjarjes, edhe në rast se do të konstatohet element i ndonjë vepre penale do të jetë ajo e “Dhunimit të banesës”, parashikuar nga neni 112/1 i Kodit Penal. Referuar nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, ai që është dëmtuar nga vepra penale e*

⁷³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 21.06.2023.

⁷⁴ Informacion për referimin e veprës penale; procesverbal këqyrje e vendit të ngjarjes; procesverbal kallëzimi nga O. O.; procesverbal deklarimi O. O., këqyrje marrje dokumentesh nga kallëzuesja, raport shërbimi.

⁷⁵ Informacion për referimin e veprës penale; procesverbale për kallëzimin e veprës penale nga O. O. dhe M. S., procesverbale deklarimi nga O. O. dhe M. M., procesverbal këqyrje, marrje dokumentesh.

parashikuar nga neni 112/1 i Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe kërkuar shpërblimin e dëmit. Në këto rrethana kallëzuesja duhet t'i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e konfliktit, qoftë sipas dispozitave të Kodit Penal, qoftë sipas dispozitave procedurale civile duke kërkuar pushimin e cenimit në pronësi [...]”. Ndërsa me vendimin e datës 01.02.2021, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, lidhur me materialin kallëzues nr. {***}, datë 08.01.2021, me arsyetimin se: “Nga studimi i materialit kallëzues, nuk konstatoj elemente të ndonjë veprë penale. [...] konflikti ndërmjet shtetasve paraqitet me natyrë juridiko civile dhe ata janë në procese gjyqësore në lidhje me pronësinë dhe pjesët takuese të tyre. Për sa i përket marrëdhënies me mbrojtësin e kallëzueses nuk konstatoj elementë të veprës penale pasi më tepër shfaqet si një marrëdhënie sqaruuese pretendimesh sesa si një kërcënim për mos vazhdimin apo pengimin e detyrës së tij”.

69.1.3 Pas ankimimit të vendimeve të mësipërme nga ana e kallëzueses, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 20.04.2021, ka vendosur shfuqizimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. {***}, datë 08.01.2021, duke vlerësuar se: “[...] vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, datë 01.02.2021, “Për mosfillimin e procedimit penal [...]” nuk është i bazuar në ligj. [...] nga ana e organit të akuzës nga njëra anë është vendosur mosfillimi i procedimit penal për kallëzimin penal të sipërcituar dhe nga ana tjetër nuk janë kryer disa veprime verifikuese. Gjykata vlerëson të theksojë se në rastin konkret organi i akuzës duhet të regjistronte procedimin penal dhe të kryente veprimet hetimore të domosdoshme për veprën penale konkrete. [...] Gjykata çmon se nga ana e prokurorisë duhet të kryhen këto veprime hetimore: -- të thirret, të pyetet dhe të japin deklarime kallëzuesja dhe bashkëshorti i saj në lidhje me kallëzimin nr. {***} të datës 08.01.2021; -- të thirret të pyetet dhe të japë deklarime i kallëzuari në lidhje me kallëzimin nr. {***} të datës 08.01.2021; -- të kërkohet dhe të administrohet nga fashikulli/dosja penale e prokurorisë, procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe fotot përkatëse të mbajtur nga OPGj, të cilët kanë bërë këqyrjen e jashtme të objektit për të cilin referon kallëzuesja në kallëzim dhe ankim”. Në zbatim të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar më datë 26.05.2021 procedimin penal nr. {***} të vitit 2021 për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal⁷⁶, si dhe janë kryer një sërë veprimesh hetimore si marrja e deklarimeve të shtetasve O. O. dhe M. M., përkatësisht në datat 01.06.2021 dhe 18.06.2021, si dhe janë administruar në datat 08.06.2021, 24.06.2021 dhe 15.11.2021 dokumente të përcjella nga këta shtetas dhe familja M..

69.1.4 Me vendimin nr. {***}, datë 10.05.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: Pranimin e ankesës. Anulimin e vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal kallëzimit nr. {***} e vitit 2020, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve”. Kundër vendimit lejohet ankim brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit. Në këtë vendim, gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se: Me të drejtë kallëzuesja O. O., pretendon interpretim të gabuar në arsyetimin e vendimit të “Mosfillimit të procedimit penal” nga organi i akuzës. Pretendon se ekziston fakti penal, por vepra penale e dhunimit të banesës ndiqet nëpërmjet nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 112/1 të Kodit Penal. Prokuroria nuk mund të arrijë në këtë konkluzion, pa u hetuar nëse është shkaktuar dëm në 7 apartamentet që sipas këqyrjes janë shkatërruar bravat e dyerve, për të cilat ankuesja pretendon se janë cilësore me vlerë 20.000 lekë të reja dhe në total kapin

⁷⁶ Kjo dispozitë parashikon veprën penale të “Vetëgjyqësisë”.

një vlerë 150.000 lekë, gjë që do të kualifikonte pas kryerjes së aktit të ekspertimit, faktin penal të “Shkatërrimit të pronës”. Prandaj gjykata do të anulojë vendimin e mosfillimit të organit të akuzës duke i caktuar si detyrë kryerjen e hetimeve të mëtejshme, si dhe kryerjen e aktit të ekspertimit për vlerën e dëmtimeve. Ky vendim i është komunikuar prokurores Flora Çela, me dëftesën e komunikimit nr. {***} akti, datë 09.06.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi të cilën evidentohet marrja dijani e këtij vendimi më datë 10.06.2021. Në zbatim të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar në datën 27.09.2021 procedimin penal nr. {***}/2021, për veprën penale të parashikuar nga neni 150⁷⁷ i Kodit Penal. Me vendimin e datës 27.09.2021, subjekti ka vendosur bashkimin e procedimit penal nr. {***}/2021, me procedimin penal nr. {***}/2021, i cili merr numrin {***}/2021. Në vijim, me vendim “Për kryerjen e ekspertimit” pa datë, të vitit 2021, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: 1. Kryerjen e ekspertimit duke bërë verifikimin në terren të apartamenteve që figurojnë të dorëzuara shtetases O. O. sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., me apartamentet që figurojnë të pasqyruara në këqyrjen e vendit të ngjarjes, nëse këto apartamente janë të njëjtë apo jo, me ata në kontratë. A figurojnë të ndryshuara bravat e derës së apartamenteve dhe konkretisht cilat apartamente. 2. Të caktoj si eksperte për kryerjen e këtij akti, ing. M. M. [...]. 4. Ekspertimi duhet të kryhet deri më datë 20.01.2022. Ky vendim i është njoftuar shtetasit M. M. dhe shtetas O. O. me shkresën nr. {***} prot., datë 29.12.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Akti i ekspertimit mbi çështjen penale me nr. {***} viti 2021 i përgatitur nga M. M., rezulton të jetë administruar në organin e prokurorisë më datë 31.01.2022.

69.1.5 Më datë 01.04.2022, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin në regjistrin e njoftimit të veprave penale të emrit të personit nën hetim M. M., i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Më datë 10.05.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë i ka përcjellë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2021 në ngarkim të të pandehurit M. M., i akuzuar për veprën penale të “Vetëgjyqësisë” e parashikuar nga neni 277 i Kodi Penal.

69.2 Në përfundim të hetimit administrativ, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit⁷⁸, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime mbi veprimet hetimore të kryera prej saj pas regjistrimit të procedimeve penale, ku, ndër të tjera, ka shpjeguar se pavarësisht faktit që data e vendimit për kryerjen e ekspertimit mungon në vendim, ajo provohet nga shkresa përcjellëse e datës 29.12.2021. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur me shpjegimet e tij edhe shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 05.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, sipas së cilës çështja është ende në gjykim në fazën e hetimeve paraprake.

69.3 Veç sa më lart, nga aktet e fashikullit të procedimit penal nr. {***}/2021, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet në Kolegj, evidentohen edhe aktet: (i) vendimi nr. {***}, datë 10.05.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili përmban vulën “Vendimi mori formë të prerë, pasi nuk u ankimua më datë 25.10.2021, Vlorë, më datë 26.10.2021”; (ii)

⁷⁷ Kjo dispozitë parashikon veprën penale “Shkatërrimi i pronës”.

⁷⁸ Në rezultatet e hetimit, Komisioni i ka bërë të njohur subjektit konkluzionin paraprak se: “Në gjendjen që ndodhen aktet deri aktualisht duket se nga regjistrimi i procedimit penal deri në regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale ka kaluar pothuajse një vit pa u ndër marrë veprime procedurale pa u cilësuar gjatë kësaj periudhe me akt veprime të tjera hetimore për tu kryer dhe pa u dokumentuar ndonjë veprim i kryer. Vendimi për aktin e ekspertimit pa datë pamundëson konkluzionin e kryerjes së veprimit hetimor në kohë ose jo. Subjektit i është kërkuar gjithashtu të qartësojë statusin aktual të çështjes”.

shkresë nr. {***} prot., datë 19.11.2021, e Gjykatës së Rrethit Vlorë, përmes së cilës i përcillen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë vendime gjyqësore të formës së prerë, ndër të cilët edhe vendimi nr. {***}, datë 10.05.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, që i përket O. O.; (iii) vendim nr. {***}, datë 04.06.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, e cila ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2021 dhe procedimit penal nr. {***} të vitit 2021, regjistruar për veprën penale “Vetëgjyqësia”, në ngarkim të të pandehurit M. M., për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”.

70. Nga analiza e fakteve dhe rrethanave të mësipërme, trupi gjykues, në konsideratë të qëndrimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë⁷⁹, vëren fillimisht se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e procedimit penal lidhur me dy kallëzimet e shtetases O. O., është bazuar vetëm në materialet procedurale të përcjella nga Komisarati i Policisë Vlorë, pa u kryer verifikime të mëtejshme nga ana e saj. Mungesa e këtyre verifikimeve është konfirmuar edhe nga kontrolli gjyqësor në të dyja rastet, e cila për këtë shkak e ka gjetur këtë vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit të pabazuar, duke e urdhëruar atë të regjistrojë procedimet penale duke i caktuar detyra konkrete. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka vepruar më pas me regjistrimin e procedimeve penale respektive dhe në funksion të hetimit të çështjes ka kryer hetime, të cilat ndryshe nga sa kishte konkluduar në fillim, i kanë konfirmuar ekzistencën e elementëve të figurës së veprës penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit që në fillim me marrjen e materialeve kallëzuese duhet të kishte kryer veprimet që më pas gjykata ia caktoi si detyra. Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se në zbatim të vendimit të gjykatës nr. {***}, datë 10.05.2021, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar pas më shumë se 3 muajsh, në datën 27.09.2021, regjistrimin e procedimit penal nr. {***}/2015 (i cili ka marrë nr. {***}/2021, pas bashkimit me procedimin tjetër penal me nr. {***}/2021), për veprën penale “Shkatërrimi i pronës” dhe ka marrë vendim për kryerjen e ekspertimit për verifikimin në terren të apartamenteve në dhjetor të vitit 2021 (referuar datës së njoftimit të këtij vendimi palëve më 29.12.2021). Në analizë të shkaqeve që mund të kenë sjellë këtë vonesë, përpos faktit që nga aktet e fashikullit të procedimit penal provohet marrja dijani e këtij vendimi më datë 10.06.2021, edhe nëse do të abstrahonim nga fakti se vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 10.05.2021, me shënimin e formës së prerë më datë 26.10.2021, i është përcjellë subjektit të rivlerësimit me shkresën e datës 19.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, regjistrimi i procedimit penal që më datë 27.09.2021, pra, përpara shënimit të formës së prerë të vendimit, dëshmon se shkak i vonesës në marrjen e vendimit për kryerjen e aktit të ekspertimit nuk ka qenë marrja e shënimit të formës së prerë e vendimit të gjykatës. Në këto rrethana, trupi gjykues e gjen sërish të pajustificuar vonesën në marrjen e vendimit për kryerjen e aktit të ekspertimit, vonesë e cila nuk mund t’i dedikohet as dorëzimit të gjithë dokumentacionit nga të dyja palët dhe konfirmimit të rrethanave faktike dhe civile të mosmarrëveshjes sikurse pretendohet nga subjekti, sa kohë që është detyrë e prokurorit të çështjes të menaxhojë me efektivitet kohëzgjatjen e veprimtarisë hetimore.

⁷⁹Në vendimin unifikues nr. 2 datë 20.06.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë theksohet se: “Rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë, mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi. Veprimet verifikuese duhen kryer në drejtim të verifikimit të shkaqeve të mosfillimit, por jo të hetimit me themel të ekzistencës të faktit penal dhe të zbulimit të fakteve lidhur me themelin e fajësisë apo të pafajësisë”.

71. Në konkluzion të sa më lart, *lidhur me gjetjet e Komisionit në 5 çështjet penale, të adresuara për vlerësim nëpërmjet shkaqeve të ankimit*, trupi gjykues i Kolegjit, pasi konfirmon përgjithësisht këto gjetje, vlerëson me peshë të veçantë problematikat në 4 (katër) prej tyre, që konsistojnë, ndër të tjera, në: (i) mungesë verifikimesh të pretendimeve të kallëzuesit përpara vendimmarrjes se nuk ekzistojnë rrethanat për regjistrimin e procedimit penal sipas parashikimit të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, në dy raste⁸⁰, konfirmuar edhe nga kontrolli gjyqësor; (ii) subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar në dy raste⁸¹ regjistrimin e procedimit penal pas më shumë se 3 (tre) muajsh nga vendimi gjyqësor që ka urdhëruar prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe vazhdimin e hetimeve, dhe ndonëse e pakushtëzuar nga ndonjë afat i caktuar në vendimin e gjykatës, apo për shkak të kushtit të parashikuar nga neni 323, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, ka nisur tej një afati të arsyeshëm e jo të justifikuar zbatimin e detyrave specifike të caktuara nga gjykata/kryerjen e veprimeve hetimore, në dy raste⁸² pas një periudhe 2-vjeçare; (iii) mungesë veprimesh hetimore ose veprime të mangëta në drejtim të identifikimit të elementëve të veprës penale, në një rast⁸³, konfirmuar edhe nga kontrolli gjyqësor. Ndërkaq, problematikat e evidentuara në çështjen penale të adresuar nga denoncuesja M. Ç. u konsideruan nga trupi gjykues pa ndonjë peshë në vlerësimin tërësor të çështjes.
72. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në sa më lart parashtruar, vëren se Komisioni shkeljet e konstatuara i ka trajtuar si mangësi në vlerësimin e kriterit profesional, duke i konsideruar të tilla që plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës. Në vlerësimin e trupit gjykues mangësitë e konstatuara në trajtimin e procedimit penal me nr. {***/2017, si procedimi penal kryesor në vlerësimin e çështjes së subjektit të rivlerësimit, në drejtim të një veprimtarie të pamjaftueshme hetimore e jo të kryer në kohë apo kohëzgjatjes së pakuptimtë, duke zbehur rëndësinë e ngjarjes, të cilat së bashku me mangësitë e konstatuara në mënyrë të përsëritur në 4 çështje penale, dëshmojnë për një *modus operandi* të subjektit të rivlerësimit që nuk pajtohet me pozicionin e saj si prokurore dhe nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të edukimit, situatë kjo që sipas nenit E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës përbën shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
73. Në vlerësimin e trupit gjykues, Komisioni nuk duhet t'i analizonte shkeljet e subjektit të rivlerësimit vetëm nën dritën e aftësive profesionale, por duhet të analizonte, gjithashtu, edhe nëse veprimet ose mosveprimet e saj cenonin besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Analiza e kryer në këtë drejtim diktohet nga parashikimet e nenit 59, pika 2 e këtij ligji, sipas së cilit, edhe nëse një subjekt rivlerësimi arrin në nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, institucionet e rivlerësimit nuk mund ta konfirmojnë në detyrë nëse konstatohet se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
74. Në rrethanat konkrete faktike e ligjore, si më sipër parashtruar, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi të një natyre serioze, në më shumë se një rast, në periudhë të shtrirë në kohë. Këto mangësi, parë në kontekstin e perceptimit të publikut, nuk mund të mos

⁸⁰ *Procedimet penale nr. {***/2018 dhe nr. {***/2021.*

⁸¹ *Procedimet penale nr. {***/2018 dhe nr. {***/2021.*

⁸² *Procedimet penale nr. {***/2018 dhe nr. {***/2018.*

⁸³ *Procedimi penal nr. {***/2019.*

kenë ndikuar këtë aspekt, qoftë për shkak të faktit që një aksion policor i përmasave të tilla, i cili passolli regjistrimin e disa procedimeve penale për një numër të konsiderueshëm personash, me një jehonë të madhe në publik, është reduktuar në drejtim të ndëshkueshmërisë vetëm me dënimin e një personi, qoftë edhe për shkak të moskryerjes apo vonesës së pajustificuar të veprimeve hetimore, të cilat kanë zbehur rëndësinë e ngjarjes dhe kanë humbur besimin e banorëve/publikut të drejtësia. Këtij aspekti i shtohet edhe ndjeshmëria apo pritshmëritë e larta të publikut në luftën kundër lëndëve narkotike si një fenomen i përhapur në vitet e fundit në vendin tonë. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se shkeljet e konstatuara të subjektit të rivlerësimit në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm përbëjnë mjaftueshëm një bazë të dhënash mbi të cilën konkludohet se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke bërë të zbatueshëm, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në mënyrë autonome, zbatimin e pikës 5 të nenit 61 të këtij ligji, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

75. Sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 802, datë 23.09.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela, nuk është i bazuar në prova dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 802, datë 23.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 23.07.2025.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi-kundër

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM NË PAKICË

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares, kam votuar kundër vendimit nr. 61, datë 23.7.2025, të dhënë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit Flora Çela, dhe jam shprehur për lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi⁸⁴, i cili e kishte konfirmuar atë në detyrë.
2. Vota ime kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues lidhet me qëndrimin e mbajtur se shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike, me anë të të cilave kërkohet ndryshimi i vendimit të Komisionit, që kishte vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, adresoheshin drejtpërdrejt dhe njëkohësisht ndaj vendimit të ndërmjetëm të marrë nga Komisioni, me nr. 4, datë 17.10.2023, me të cilin ishte vendosur pezullimi nga detyra e subjektit të rivlerësimit dhe detyrimi i saj për të ndjekur programin njëvjeçar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, vendim i cili, në zbatim të parashikimeve kushtetuese të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk është një vendim i ankimueshëm, si dhe ndaj vendimit përfundimtar nr. 802, datë 23.09.2024.
3. Në rastin konkret, për shkak të konstatimit se shkaqet e këtij ankimi lidhen vetëm me vendimin e ndërmjetëm të Komisionit dhe vlerësimin që Komisioni ka bërë për dhënien e masës së pezullimit, pa adresuar asnjë çështje tjetër të re, që mund të ketë rezultuar nga hetimi administrativ, në vlerësimin tim, ky ankim duhej rrëzuar si i pambështetur në Kushtetutë dhe në ligj.
4. Arsyetimi kundërshtues lidhur me qëndrimin ligjor dhe interpretimin që unë si pakicë i kam bërë shkaqeve të ankimit, është shtjelluar në mënyrë të detajuar dhe shteruese në një rast të ngjashëm shqyrtuar në Kolegj dhe është shprehur në mendimin e pakicës ndaj subjektit të rivlerësimit Marsida Frashëri⁸⁵, ku i është dhënë përgjigje disa çështjeve, të cilat identifikohen si vijon:
 - Nëse faktet e shtruara për analizë në ankim janë të njëjtat me ato të trajtuara prej Komisionit në analizën për vendosjen e masës së pezullimit apo ato kanë edhe elemente të tjera, të cilat mund të analizohen në kuadër të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016;
 - Nëse ankim i ndaj vendimit të konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit është një ankim i maskuar apo i tërthortë i vendimit të pezullimit dhe dërgimit në Shkollën e Magjistraturës;
 - Nëse parashikimi kushtetues lejon kontrollin e vendimit të ndërmjetëm të Komisionit për pezullim dhe dërgimin në Shkollën e Magjistraturës, edhe në mënyrë të tërthortë apo incidentale;
 - Nëse kontrolli i një vendimi të tillë vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe në shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe mosdënimit dy herë për të njëjtën shkelje.
5. Në vlerësim të çështjes së parë evidentohet qartësisht se nga arsyetimi i shumicës nuk rezultojnë të jetë analizuar asnjë rrethanë apo fakt i ndryshëm/i ri, pra nuk ka lëndë të re e të patrajtuar në vendimin e ndërmjetëm për pezullim nga detyra, nga ato të vlerësuara prej Komisionit,

⁸⁴ Vendimi nr. 802, datë 23.09.2024 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Flora Çela.

⁸⁵ Në vendimin nr. 46, datë 10.06.2025, gjyqtaret Ina Rama dhe Mimoza Tasi kanë shprehur mendimin dhe qëndrimin ndaj votës kundër vendimit të shumicës së trupit gjykues.

përveçse një vlerësim të ndryshëm lidhur me peshën e shkeljeve dhe ndikimin që ato duhej të kishin mbi vendimin përfundimtar të procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, qëndrimi i pakicës mbështetet në konkluzionin e arritur nga shumica se e gjithë analiza e shqyrtimit të shkaqeve të ankimit bazohet mbi të njëjtat fakte për të cilat është marrë vendimi i ndërmjetëm i Komisionit, për pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe dërgimin në Shkollën e Magjistraturës, por me një vlerësim të ndryshëm.

6. Ankimi i Komisionerit Publik, që formalisht, *a prima facie*, ankimon vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin tim si pakicë, konteston faktikisht vendimin e ndërmjetëm të Komisionit për pezullimin nga detyra dhe dërgimin e subjektit në Shkollën e Magjistraturës. Shkaqet e ankimit të ngritura në ankimin objekt gjykimi i adresohen tërësisht problematikës së analizuar në kuadër të vendimit të ndërmjetëm për dërgimin në shkollën e Magjistraturës si një ankim i *maskuar/tërthortë*, në shmangie të pengesës kushtetuese për ushtrimin e ankimit ndaj këtij vendimi. Në këtë mënyrë, ankimi i ankuesit duke kontestuar vendimin për konfirmimin, për të cilin Komisioneri gëzon ligjërisht *ratione personae*, ka synuar indirekt ankimin e vendimit për pezullim, për të cilin nuk e gëzon këtë të drejtë.
7. Parë në këndvështrim të parashikimeve kushtetuese⁸⁶ dhe ligjore⁸⁷, pakica vlerëson se ndaj këtij vendimi të Komisionit nuk mund të ushtrohet kontroll nëpërmjet ankimit, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Në një lexim harmonik të këtyre parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës arrihet në konkluzionin se vendimi i Komisionit, për pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe urdhërimin për ndjekje të programit njëvjeçar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, është një vendim ndaj të cilit nuk lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe për të cilin Kolegji nuk gëzon juridiksion *ratione materiae*.

7.1. Përjashtimi që bën neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës për të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi lexohet si qëllim i ligjvënësit për të mos lejuar kontrollin mbi të, në mënyrë përjashtimore dhe të shprehur. Ky përcaktim kushtetues nuk lejon as ankimin e tij me vendimin përfundimtar, siç është ai i konfirmimit, pasi parashikimi kushtetues nuk ndalon vetëm ankimin e veçantë, por gjithashtu nuk lejon ankim ndaj tij në asnjë stad/fazë të procesit të rivlerësimit, duke i dhënë formë të prerë me ligj, dhe madje duke sugjeruar edhe ekzekutimin e tij të menjëhershëm. Në këtë kuptim, çështjet e analizuar në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe për të cilat Komisioni, si organi kompetent, ka urdhëruar pezullimin

⁸⁶ Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji, subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit E, paragrafi 2, të Aneksit.*

Neni E, paragrafi i 2 i Aneksit të Kushtetutës parashikon se: *Vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra, shoqëruar me detyrimin për trajnim identifikon mangësitë. Gjatë periudhës së pezullimit, të rivlerësuarit i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj. Subjekti i rivlerësuar urdhërohet të ndjekë një program edukimi njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, i hartuar për të plotësuar mangësitë. Në fund të programit, ai testohet për aftësitë e tij. Ky testim mbikëqyret nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. Subjekti i rivlerësimit që nuk e kalon testimin shkarkohet nga Komisioni.*

Neni E, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se: *Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, atëherë kjo konsiderohet mangësi profesionale dhe zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit, shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.*

⁸⁷ Neni 44, shkronja "c" e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *Në përfundim, relatori propozon për subjektin e rivlerësimit si më poshtë: b) "Me mangësi", kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv. Komisioni ka rekomanduar program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës për të plotësuar këto mangësi brenda një viti.*

dhe dërgimin në Shkollën e Magjistraturës, nuk mund t'i nënshtrohen kontrollit të Kolegjit për shkak të ankimit të një prej palëve, por as të vlerësohen prej tij në mënyrë incidentale, për sa kohë që Kolegji shqyrton çështjet si një gjykatë apeli, brenda kufijve të shkaqeve të ankimit.

8. Pakica vlerëson se kontrolli i këtij vendimi dhe pranimi i ankimit të Komisionerit Publik, për ndryshimin e vendimit të Komisionit, nëpërmjet një ankimi të tërthortë ndaj vendimit të ndërmjetëm të pezullimit nga detyra, është gjithashtu në kundërshtim në mënyrë të posaçme me parimin e mosdënimit/ndëshkimit dy herë për të njëjtën shkelje (si pasojë e zbatimit të parimit *ne bis in idem*), si një aspekt i parimit *res judicata*, i lidhur me masat me natyrë ndëshkuese. Subjekti i rivlerësimit, për shkak të mangësive të konstatuara në drejtim të kriterit të aftësive profesionale, është ndëshkuar disiplinarisht nga Komisioni me masën disiplinore⁸⁸ të pezullimit nga detyra dhe urdhërimit për ndjekjen e detyruar të trajnimit njëvjeçar në Shkollën e Magjistraturës. Pra, pezullimi nga detyra e subjektit është një prej masave disiplinore të parashikuara nga kuadri ligjor lidhur me procesin e rivlerësimit. Në të njëjtën linjë vlerësimi, Kolegji në jurisprudencën e tij, ka pranuar shprehimisht se pezullimi nga detyra dhe detyrimi për ndjekjen e programit të trajnimit njëvjeçar, është një nga masat disiplinore, të cilat janë parashikuar se mund të vendosen në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar⁸⁹. Në këto kushte, vendosja e një mase të dytë më të rëndë, pas ekzekutimit të plotë të një mase disiplinore për të njëjtat fakte, përbën një dënim të dyfishtë dhe cenon sigurinë juridike, në kundërshtim me nenin 4, të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, sipas standardit të vendosur në çështjen *Sergey Zolotukhin v Russia*⁹⁰. Për sa më lart, situata faktike e krijuar vjen për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore dhe dënimit dy herë të subjektit, tashmë me një masë edhe më të rëndë, madje ekstreme, megjithëse për të njëjtat shkelje ajo është konsideruar se ka shlyer ndëshkimin dhe madje është korriguar nëpërmjet trajnimit në Shkollën e Magjistraturës.
9. Për të gjitha arsyet dhe argumentet që janë renditur përmbledhtazi në dhënien përgjigje çështjeve të mësipërme, pas një analize harmonike të kuadrit kushtetues dhe ligjor, si dhe duke rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur në analizën e plotë ligjore të këtij rasti, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Flora Çela, pasi Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës ka arritur në përfundimin se mangësitë e konstatuara janë ndrequr përmes programit të trajnimit njëvjeçar dhe në ankimin e Komisioneres Publike nuk ekziston asnjë rrethanë tjetër e re, e pretenduar që do të meritonte një trajtim të ndryshëm ligjor.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

⁸⁸ Neni 58 i ligjit nr. 84/2016, i titulluar “Masat disiplinore”, parashikon se: Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit: a) konfirmimin në detyrë; b) pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës; c) shkarkimin nga detyra.

⁸⁹ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit me: nr. 46, datë 02.11.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo; nr. 13, datë 05.04.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Juljan Çafka dhe nr. 38, datë 25.07.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Laurent Fuçia.

⁹⁰ <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-91222>